

Akoma nuk keni një website?

Akoma nuk jeni regjistruar në Google

Për çdo konsultim mund te vini në çdo kohë në zyrat tona

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road, London, E13 8HT
Tel:020 7018 7929 Mob: 073 4066 5946 Mob:078 5997 7545




The **Albanian**

VITI I 21 I BOTIMIT 25 MAJ 2025

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

A DËSHTOI VIZITA E STARMER NË TIRANË?



PETRIT KUÇANA

PËRSE 'U HARRUA' ANGZHIMI BRITANIK PËR HEKURUDHËN DURRËS-PRISHTINË?



ARBEN MANAJ

"TRAFIKIMI I EMIGRANTËVE TË PALIGJSHËM VIJON ENDE" REPORTAZHI I BBC: KALIMET BËHEN ME JAHTE PRIVATE DREJT ANGLISË, RISK...

RRUGA E PREMTIMEVE

DAUT DAUTI



KLORI I GARDHIT, VOTA E GETOS

SONILA MEÇO



BËJENI PËR HIR TË KOSOVËS!

MAL BERISHA



SHQIPËRINË DO E NGULFATË HESHTJA E FRIKAKAKËVE QË DUHET TË FLASIN DHE ZHURMA E INTERESKHINJVE PA DINJITET!

KIM MEHMETI



DUKE KËRKUAR QENDRËN: KRIZA E HESHTUR KOSOVARE (DHE EVROPIANE)

VETON SURROI



Rashid A.Khan Solicitor (Principal) Mob: 07774222062 190 MERTON HIGH STREET WIMBLEDON, LONDON SW19 1AX



RASHID & RASHID

Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths




The Albanian newspaper in London

THE ALBANIAN
www.thealbanian.co.uk

www.thealbanian.co.uk

albania7@gmail.com

Tel: 020 7018 7929



PETRIT KUÇANA

Nuk u deshën shumë kohë, që çdo lloj etiketimi i vizitës së parë të një kryeministri britanik, si historike, të zhvlerësohet thajse totalisht.

Është goxha shumë e vështirë që të gjendet ndonjë 'e arrirë' e kësaj vizite, e mbase shumëkush do të mund ta krahasonte me vizitën e parë të presi-

A DËSHTOI VIZITA E STARMER NË TIRANË?

dentit Macron, kur kërcënoi për refuzimin e vizave për Kosovën në krah të kryeministrit Rama.

Mbase nuk është shumë i rëndësishëm as refuzimi i Ramës për kampet e emigrantëve, e çuditërisht duket se mënyra sesi u tha bëri më shumë përshtypje (në median britanike u cilësua si poshtërim ndaj Starmer).

Pikërisht ajo çfarë ra në sy, ishte ngritja e zërit për çështjen e shqiptarëve të Britanisë që kanë rreth tre dekada këtu me identitet të ndryshuar. Duket sikur Rama lau duart me 'përmendjen' e këtij problemi dhe se, u pa qartë, se nuk ka arritur që të bindë britanikët që të ndërmerret ndonjë masë për këtë problem.

Nuk ka qenë thjesht një premtim elektoral, por vërtet prej vitësh mbetet një problem që kërkon zgjidhje.

Ajo çfarë ka qenë thajse e qartë nga

autoritetet britanike, për çdo kërkesë të palës shqiptare, është se Britania nuk mund të ndërmarrë nisma ligjore vetëm për një kombësi të caktuar. Sistemi juridik mbetet tejet kokëfortë dhe se shanset për ndonjë 'nismë ligjore' janë realisht të vogla.

Duhet theksuar se nuk janë vetëm shqiptarët që kanë përdorur një identitet tjetër për të fituar të drejtën e qendrimit në Britani. Janë shumë e shumë kombësi të tjera që kanë 'përvetësuar' praktika të tilla dhe se çdo lloj gjukimi bëhet vetëm për çështje individuale.

Kjo ishte gjëja e parë që ra në sy në konferencën e përbashkët për shtyp mes dy kryeministrave dhe natyrisht me problemet që ka Britania me Shqipërinë qoftë për emigracionin e paligjshëm, apo për krimin e organizuar.

Duhet theksuar se janë mbi 13 000 shqiptarë që janë kthyer nga Britania

pas marrëveshjes Rama-Sunak. Madje Ministria e Brendshme Britanike në një ndër video-reklamimet e saj ka pikërisht për subjekt shqiptarët që kthehen në Tiranë, por problemi britanik qëndron në faktin se shqiptarët e dëbuar po rikthehen në Britani.

A do të ketë lehtësim të vizave për shqiptarët që duan të punojnë në Britani?

A do të ketë ndonjë nismë për shqiptarët 'pa letra' në Britani?
Asnjë gjysëm fjale për ta...

Ajo çfarë u harrua thajse fare ishin investimet britanike, dhe se shakaja e Ramës për nivelin e shkëmbimeve tregtare, që nuk e kalojnë buxhetin e Crystal Palace flet shumë për gjithçka.

Çuditërisht u harrua terësisht angazhimi britanik për të ndërtuar

hekurudhën Durrës-Prishtinë.

U harrua angazhimi i ish-ministrit të jashtëm (ish-kryeministrit) në vizitën disa orëshe në Tiranë David Cameron. "Kemi projekte shumë emocionuese, si për shembull hekurudha që ju shpjeguat, pra nga Prishtina në Durrës, që do të jetë shumë, shumë e rëndësishme, jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për Kosovën dhe për të gjithë rajonin" pati thënë Cameron.

Mbetet pikëpyetje e madhe se përse u tërhoqën britanikët apo çfarë ndodhi? Çuditërisht një ditë më vonë Rama-Macron u shprehën për angazhimin francez për këtë hekurudhë...

Mbase është shumë shpejt që të rendet për konkluzionet e kësaj vizite, por deri më sot askush nuk e di se cilat kanë qenë përfitimet e Shqipërisë nga marrëveshja Rama-Sunak.

Mbretëria e Bashkuar ka përjetuar një rënie të paprecedentë prej 50% të imigracionit neto në vitin 2024, sipas të dhënave zyrtare të publikuara nga Zyra për Statistikat Kombëtare (ONS).

Raporti vjetor evidenton një ulje të fluksit migrator nga 860,000 në vitin 2023, në 431,000 persona gjatë vitit të kaluar, shifër që po përdoret politikisht si sukses nga të dyja palët kryesore politike në vend: Partia Laburiste dhe ajo Konservatore.

Kjo rënie e ndjeshme vjen në një vit të ngarkuar politikisht, ku pushteti u nda mes dy partive kryesore.

Deri në zgjedhjet e parakohshme të 7 korrikut, qeveria konservatore e drejtuar nga Rishi Sunak aplikoi një sërë politikash kufizuese, përfshirë rritjen

Kryeministri britanik Sir Keir Starmer ka bërë thirrje për të lënë mënjane "luftërat politike" që kanë ndarë vendin që nga referendumi i Brexit-it, pasi Mbretëria e Bashkuar dhe Bashkimi Evropian kanë arritur një marrëveshje të re gjithëpërfshirëse që synon të rivendosë dhe forcojë marrëdhëniet dypalëshe.

Marrëveshja, e cila u finalizua të dielën mbrëma përpara një samiti të nivelit të lartë në Londër me pjesëmarrjen e krerëve të BE-së Ursula von der Leyen dhe António Costa,

e pragut të pagës për punëtorët e huaj të kualifikuar dhe pengesat për studentët dhe punëtorët që donin të sillnin familjet me vete.

Më pas, qeveria kaloi në duart e laburistëve nën drejtimin e Keir Starmer, i cili ka ruajtur një vijë të fortë mbi çështjet e migracionit.

Ekspertët e ONS theksojnë se frenimi i imigracionit është ndikuar kryesisht nga ulja e dhënies së vizave për punë dhe studim, një politikë që ka ndikuar ndjeshëm sidomos pas Brexit. Megjithatë, zërat kritikë paralajmëro-

jnë se këto masa mund të kenë pasojë të rënda për ekonominë britanike.

Britania përballet me një krizë të dyfishtë: plakjen e popullsisë dhe mungesën e fuqisë punëtore të kualifikuar në sektorë kyç si shëndetësia, ndërtimi dhe teknologjia.

Ekspertët të pavarur kanë paralajmëruar se nëse flukset migratore vazhdojnë të kufizohen, vendi rrezikon të përballet me ngadalësim ekonomik ose recesion.

MARRËVESHJA BRITANI-BE, STARMER BËN THIRRJE PËR T'I LËNË PAS DEBATET E BREXIT-IT

përfshin fusha kyçe si peshkimi, tregtia, mbrojtja, energjia dhe bashkëpunimi politik. Një element thelbësor është leja e aksesit të anijeve evropiane në ujërat britanike për një periudhë 12-vjeçare, në këmbim të lehtësimeve për barrierat tregtare midis të dyja palëve.

Sir Keir Starmer e përshkroi marrëveshjen si një "moment për të parë përpara" dhe për të zhvendosur

fokusin nga përçarjet që kanë karakterizuar periudhën pas Brexit-it. "Është koha të largohemi nga debatet e vjetra dhe grindjet politike, për të gjetur logjikë të shëndoshë dhe zgjidhje praktike që u japin më të mirën njerëzve tanë," tha ai në samit.

Ai shtoi se qeveria britanike është e gatshme të punojë me partnerët evropianë në çdo fushë që sjell përfitime konkrete për qytetarët.



Ndërkohë, rënia e migracionit është përdorur si trampolinë politike nga krahu i djathtë radikal.

nga një forcë proteste në një konkurrenca serioze në skenën kombëtare

Partia Reformiste, e udhëhequr nga figura e njohur e Brexit, Nigel Farage, ka shënuar rritje të ndjeshme në sondazhe dhe në zgjedhjet lokale të fundit. Kjo e ka kthyer partinë

vlerësoi liderhipin e Kryeministrit Starmer për arritjen e kësaj marrëveshjeje. "Po kthejmë një faqe.

Po hapim një kapitull të ri në marrëdhënien tonë," tha ajo, duke shtuar se kjo marrëveshje do të bëjë "një ndryshim të vërtetë për njerëzit në Mbretërinë e Bashkuar dhe në të gjithë Bashkimin Evropian", sidomos në një kontekst paqëndrueshmërie globale.

Presidentja e Komisionit Evropian Ursula von der Leyen e përshkroi samitin si një "moment historik" dhe

**TELEFONONI SHQIP
07468 759953**



**141 CHRISTIAN STREET
LONDON E1 1RS
TEL: 02081096550**

**A DËSHIRONI TË BËHENI ELEKTRIÇIST
I KUALIFIKUAR?**

**A DËSHIRONI
GOLD CARD?**



**18 edition - Level 3 Award in the
Requirements for Electrical
Installations BS 7671:2018**

**EAL Level 3 Award in Electrical
Installation Inspection,
Testing, Certification and
Reporting 603/2625/6**

**501/1605/8 Installing
Electrotechnical Systems and
Equipment NVQ**

**AM2 Assessment of
Occupational Competence**



**COLLEGE OF
LONDON ME
PRONAR SHQIPTAR**



**www.collegeoflondon.org.uk
info@collegeoflondon.org.uk**



ARBEN MANAJ

Reportazhi i gjigantit mediatik britanik, BBC, përmes një ish-ushtaraku britanik të shndërruar në trafikant të emigrantëve ilegalë, zbulon se rruga e vjetër e kalimeve ilegale përmes jahteve private që ankorohen nëpër porte të vogla dhe marina private vazhdon të mbetet si më parë, një rrugë e lehtë për transportimin e emigrantëve nga Franca drejt brigjeve angleze në jug dhe juglindje të ishullit.

Sipas tij, shumica e atyre që ai ka transportuar janë vietnamezë dhe shqiptarë, dhe këto rrugë dhe metoda ende aplikohen edhe sot e kësaj dite, çka përbën "një risk realisht shqetësues" për autoritetet e Forcës Kufitare britanike.

"TRAFIKIMI I EMIGRANTËVE TË PALIGJSHËM VIJON ENDE" / REPORTAZHI I BBC: KALIMET BËHEN ME JAHTË PRIVATE DREJT ANGLISË, RISK...

Marinat private ku ankorohen jahtet e vogla kanë po aq masa sigurie sa kanë edhe kampingjet e makinave private, thuhet në reportazhin e BBC.

Sipas ish-ushtarakut britanik, i futur në këtë rrugë nga një tjetër shqiptar, e që ka bërë më shumë transportin e shqiptarëve, ai i fshihte emigrantët shqiptarë në makina që hipnin nëpër tragete që vinin nga Franca, të cilët, me të hipur në target, më pas hipnin nëpër maune dhe kamionë nëpër këto tragete të parkuara ndërkohë në pjesën e poshtme të trageteve të linjës gjatë udhëtimit drejt Anglisë.

Ish-ushtaraku i dënuar me të cilin ka biseduar BBC, thotë se kjo mbetet një rrugë e lehtë dhe pa rreziqe për kalimet ilegale, krahasuar me ato me gomone nëpër La Mansh apo Kanalin Anglez, siç e quajnë anglezët, por ai është i irrituar për dënimin që ka marrë, kur të njëjtat metoda dhe rrugë që përdorte ai, në bashkëpunim me një trafikant shqiptar dhe vietnamez, të dy këta të dënuar po ashtu dhe të liruar ndërkohë, ende aplikohen edhe sot e kësaj dite.



Sipas trafikantit britanik, ndryshe nga shumë emigrantë që kalojnë La Manshin me gomone, shumica e trafikuar prej tij nuk dëshironin të kapeshin nga autoritetet britanike për të kërkuar zyrtarisht azil, pasi kërkonin të kalonin në të zezë për të jetuar dhe punuar edhe nëpër shtëpitë e barit, ku kultivohet kanabisi.

Ish-ushtaraku britanik më shumë ka

trafikuar shqiptarë, kryesisht meshkuj, të cilët, sipas tij, ishin kthyer disa herë nga autoritetet britanike të emigracionit dhe riktheheshin në Britani.

Kalimet e deritanishme përmes La Manshit shkojnë në rreth 13 mijë vetë deri më sot dhe mundet që ky vit të jetë vit rekord pas ardhjes së Laburistëve në pushtet.

Por kalimet përmes mënyrës së përkthuar në reportazhin e BBC-së është e vështirë t'u vihet një shifër, pasi nuk ka vlerësime të publikuara se sa emigrantë ilegalë hyjnë në Britani përmes porteve të vogla detare dhe marinave ku parkohen jahtet private.

Dotech
website 

Për çdo konsultim mund të na kontaktoni
ose mund të vini në zyrat tona

- BUSINESS CARDS
- LOGO
- BANNERS
- POSTERS
- VIDEO MARKETING



Tel: 020 7018 7929



Mob: 073 4066 5946




Mob: 078 5997 7545

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road London E13 8HT



Dotech
website



**A JENI
REGJISTRUAR
NË GOOGLE?**

AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

Ne mund t'iu ndihmojme edhe me:

-Business Cards

-Logos

-Banners

-Posters

-Flyers

-Video Marketing

Për çdo konsultim mund te vini në zyrat tona

CONTACT US

Tel:020 7018 7929 Mob: 073 4066 5946 Mob: 078 5997 7545

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road, London E13 8HT

DAUT DAUTI

RRUGA E PREMTIMEVE



Rruga Daut Dauti fillon në dalje të fshatit Llovçë dhe përfundon në fshatin Kokaj, që është vendlindja ime dhe ku është vendosur kufiri me Serbinë.

Kjo rrugë nuk është emëruar sipas meje, por sipas gjyshit tim, i cili, në vitin 1944, ka rënë heroikisht duke e mbrojtur kufirin e shtetit shqiptar, që atëherë ka qenë vija e hekurudhës Preshevë – Bujanoc.

Gjyshi im është vrarë afër Bilaçit duke i ndjekur forcat e kombinuara çetniko-komuniste, që tentonin të hynin në Kosovë.

Sot, kjo rrugë me gjatësi 2 deri në 3 kilometra, mund të jetë e vetmja e pa asfaltuar në Kosovë. Secila qeveri lokale e Gjilanit dhe ato qendrore të Kosovës, në fushatat parazgjedhore kanë premtuar asfaltimin e saj. Në secilën fushatë kanë nisur punimet, por nuk kanë përfunduar



kurrë.

Njësoj ka ndodhur edhe në fushatën e fundit të zgjedhjeve lokale kur një kompani dërgoi makineri serioze për asfaltim, e cila gjë i gëzoi banorët, të cilët besuan se këtij premtimi më në fund i erdhi fundi.

Por, kompania bëri ca punë rreth shtratit të rrugës dhe u largua menjëher pas përfundimit të zgjedhjeve.

Askush nga autoritetet lokale apo qendrore nuk ofron spjegim të kësaj gjendjeje, që duket si lojë apo tallje me banorët e kësaj ane. Por, ajo që

dihet është fakti se pushteti qendror në Prishtinë i ka ndarë mjetet, por askush nuk e di arsyeën pse nuk realizohet ky projekt.

Fshati Kokaj tani më është boshatisur. Nga 40 shtëpi, sa kishte me banorë para luftës, sot ka rënë në 3 apo 4 sosh.

Kjo gjendje me siguri reflektohet në sytë e partive politike, të cilat nuk shohin votues potencial në këtë anë të komunës së Gjilanit.

Sidoqoftë, kjo është një neglizhencë e çuditshme dhe e palogjikshme për shkak se kjo rrugë i

lidhë me Kosovën edhe një mori të fshatrave shqiptare të Karadakut që kanë mbetur matanë kufirit. Kjo rrugë tani më ka mbetur si simbol i premtimeve të rrejshme politike.

Nuk po flas për faktin se rruga duhet të kryhet edhe për shkak të emrit të njerit nga dëshmorët, që kanë dhënë jetën për mbrojtjen e Kosovës, që në këtë rast është gjyshi im.

Kjo, për fat të keq është një kërkesë e tepërt nëse e kemi parasyshë katandisjen e qeverisjes tonë qendrore apo lokale, e cila nuk ka aftësi e as dëshirë ta respektojë heroizmin e së kaluarës.

Dotech

website 

“ **AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE PËR BIZNESIN TUAJ?** ”

Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

Adresa e zyrave:

30 Avenons Road London E13 8HT



Tel: 020 7018 7929



Mob: 073 4066 5946



Mob: 078 5997 7545



The Albanian

**TRANSPORT
APOLLONIA**



**TRANSPORT
MAKINASH
ANGLI-SHQIPËRI**

00447429200952

**OFRON SHERBIME TRANSPORTI
MAKINA
MOTORCIKLETA
PJESË MAKINASH
MAKINERI BUJQËSORE
MOBILJE
FASADA XHAMI
DYER & DRITARE, MOBILIERI ETJ**



00355682948843

00355694031009

00447429200952

**TRANSPORT MALLRASH
ANGLI-SHQIPËRI
SHQIPËRI-ANGLI**



www.transportapollonia.co.uk



**LETËR E HAPUR DREJTUAR
PARLAMËNTARËVE TË
KOSOVËS
JO MË 48 ORË!**

Parlamentarë të Kosovës!

Po ju drejtohem me një zë të mekur, por me një shpirt të mbushur me dashuri të pakushtëzuar për Kosovën. Po ju flas si një ndër shtetasit më të vonshëm të Republikës së Kosovës, me rrënjë në Malësinë e Gjakovës dhe me zemrën gjithmonë atje.

Jo për hatrin tim.

As për zërin tim, më të pa-pushtetshmin e më të pa-ndikueshmin zë! Por për hir të atyre që nuk flasin më, por që na kanë lënë një amanet të përjetshëm.

Për hir të brezave që e patën Kosovën ëndrën e tyre më të madhe, dritën e jetës së tyre.

Për ata që ëndërruan një Shqipëri dhe një Kosovë të bashkuara në liri, demokraci dhe dinjitet.

Për ata që u martirizuan duke mbrojtur tokën e saj të bekuar.

Për qindra mijëra të vrarë nga shovinizmi serb dhe regjimi komunist jugosllav, para, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore.

Për të burgosurit politikë që u kalbën në qelitë e Goli Otokut.

Për më shumë se 13.000 shqiptarë të vrarë gjatë luftës së fundit.

Për mbi 20.000 gra dhe vajza që përjetuan të pa-thënshmen, të pa-tregueshmen.

Për hir të Reçakut dhe Prekazit, që u bënë altarë të shenjtë të lirisë.

Për një milion shqiptarë e dëbuar me dhunë, që falë miqve tanë perëndimorë u kthyen sërish në tokën e tyre, pasi Serbia u dëbua me forcë nga Kosova.

Për emigrantët që lanë familjet, shkuan në Perëndim dhe punuan

BËJENI PËR HIR TË KOSOVËS!



punët më të rënda për të mbajtur gjallë Kosovën.

Për shqiptarët e Shqipërisë, Maqedonisë, Malit të Zi dhe diasporës që dhanë gjithçka për lirinë tuaj.

Për patriotët që u vranë sepse besuan në idealin e shtetformimit të Dr. Ibrahim Rugovës.

Për hir të Adem Jasharit, që dha jetën e tij dhe të gjithë familjen së tij për Kosovën.

Për heronjtë dhe dëshmorët e UÇK-së dhe për familjet që jetojnë me boshllëkun e përjetshëm.

Për miqtë ndërkombëtarë që investuan shpresë, para, ushtri dhe mbështetje për të çliruar dhe ndërtuar

shtetin demokratik të Kosovës.

Për hir të Kosovës – që nuk është pronë personale e asnjërit prej Jush, (në çfarëdo pozite që të jeni sot), por është amanet kombëtar, që duhet ruajtur si sytë e ballit.

Për hir të të gjithë këtyre gjërave që rendita më lart – ndalojeni këtë farsë politike!

• Mos lejoni që dështimi i njëzetënjëti i Kuvendit të Kosovës të bëhet simbol i paaftësisë suaj.

• Mos u bëni qesharakë para botës, duke regjistruar një rekord turpi në historinë e parlamentarizmit.

• Mos e ktheni çdo 48 orë në përsëritje këtë farsë të padenjë!

• Mos e kërkonin fajin te njëri-tjetri – kërkojeni te vetja.

Për këtë jeni aty: për të marrë përsipër përgjegjësi, dhe jo për të ia hedhur fajin kundërshtarit politik.

• Mos e bëni botën të besojë se Ju nuk jeni të zotë të qeverisni.

• Mos i vërtetoni tezat më armiqësore e më shoviniste anti-shqiptare.

• Mos e bëni popullin tuaj të besojë në atë se Ju nuk keni vizion për shtetin që Ju dhe para-ardhësit tuaj e ndërtuat së bashku me aleatët.

• Mos e lejoni që historia në të ardhmën të shkruaj, se ishit Ju ata që nuk qetë të denjë për sakrificën që bënë të parët e këtij vendi për brezin

tuaj.

• Mos i ia bëni qejfin armikut inatet e përçarjet tuaja të anti-kombëtare; Ai po ju vëzhgon dhe mezi pret t'ju godasë pikërisht kur Ju jeni më të dobët. Ju nuk jeni aty për të shkatërruar njëri-tjetrin.

• Ju jeni aty për të ndërtuar bashkë një Kosovë të fortë, demokratike, dinjitoze.

• Ju jeni aty për të përfaqësuar popullin – jo për të zhgënjyer ata që ju besuan.

• Ju jeni aty për t'i bërë ballë Serbisë, e cila po ndjek me vëmendje çdo lëvizje tuajën të gabuar, dhe po kënaqet. E madje ajo edhe po përkëdhelet nga Evropa. Mos harroni asnjë çast se Serbia është dora e zgjatur e Ruisisë që ka destabilizuar mbarë kontinentin.

Kështu pra, për hir të gjithë këtyre gjërave që thashë më lart – mos e çoni dem këtë amanet! Kjo, pasi ky është amaneti i atyre që ju kanë votuar,

është amaneti i atyre që sakrifkuan jetën për Kosovën, është amaneti i brezave që do vijnë të cilët e meritojnë një Kosovë demokratike, një Kosovë evropjane dhe të begatë.

• Për hir të Kosovës – merruni vesh!

• Për hir të së ardhmes – tregoni përgjegjësi!

No more 48 hours.

No more 21 failed parliamentary sessions.

No more shame!

Vetëm dinjitet për Kosovën!

Me respekt e përunjësi

Mal Berisha

KIM MEHMETI

Shqipëria hesht edhe kur ia rrënojnë Teatrin Kombëtarë dhe mbëmendjen shqiptare, siç hesht edhe kur fatin e drejtuesve të saj nuk e përcaktojnë zgjedhjet e lira dhe demokratike, por 'votimi'.

Shqipëria hesht edhe kur kryetarin e Akademisë dhe drejtuesit e institucioneve kulturore e shkencore ia emëron Kryeministri i vendit, siç hesht edhe kur kryeredaktor i vetëm i gjitha mediave është Piktori.

Shqipëria hesht edhe kur e dinë se thuajse të gjithë elitat dhe institucionet e saj i financon dhe i kontrollon krimi, siç hesht edhe kur në mes të rrugës kidnapohet e merret zvarrë nga policia ish presidenti i vendit dhe njëri nga drejtuesit e opozitës.

Shqipëria hesht edhe kur e sheh qartë se politikanët s' merren me fatinë e saj dhe të popullit, por vetëm me mirëqenien e familjarëve të vet, siç hesht edhe kur grupet kriminale i caktojnë listat e kandidatëve për deputet.


SHQIPËRINË DO E NGULFATË HESHTJA E FRIKACAKËVE QË DUHET TË FLASIN DHE ZHURMA E INTERESHXHINJVE PA DINJITET!

Në Shqipëri dëgjohe vetëm zhurma e debatuesve të paguar për ta mbuluar të vërtetën se administrata shtetërore paguhet vetëm për ta votuar Piktorin, pra zhurma e atyre që paguhet të mos flasin për atë nëse zgjedhjet kanë qenë të barabarta për të gjithë pjesëmarrësit në të, por për të metat e opozitës?!

Pra në mëmëdhe bërtasin e dalin nëpër ekranet televizive ata që duhet ta mbulojnë të vërtetën se të huajt i pranojnë zgjedhjet 'alla shqiptarçe' ngaqë e dinë se Shqipëria nuk ka studentë që do u hipnin biçikletave që të shkonin deri në Bruksel, ku do rrëfenin për profesorët e tyre që i përkulen vetëm partisë në pushtet.

Po, Shqipëria i hesht të vërtetat që duhet t'i thotë zëshëm dhe i bërtet gënjeshtrat që e mbulojnë të keqen e quajtur 'aleanca e qelbësirave' me në krye Piktorin.

Andaj nëse në Shqipëri edhe më tej nuk do dëgjohe zëri i guximit qyte-



tarë dhe nëse në mëmëdhe nuk do e mbyllin gojën ata që duhet të turpëro-

hen kur flasin, atëherë atë do e ngulfatë heshtja e frikacakëve që duhet të

flasim dhe zhurma e interesxhinje pa dinjitet.

Kryeministrat e Mbretërisë së Bashkuar dhe Maqedonisë së Veriut, Keir Starmer dhe Christian Mickowski, arritën një marrëveshje për një “partneritet strategjik” midis dy vendeve gjatë takimit të tyre më herët sot në Tiranë.

Kryeministrat e të dy vendeve vlerësuan se marrëveshja do të thotë bashkëpunim edhe më i fortë, marrëdhënie më të forta dhe një mundësi për të thelluar marrëdhëniet e tyre.

“Ne kemi një marrëdhënie të fortë midis dy vendeve tona. Fakti që arritëm këtë marrëveshje është me rëndësi të madhe dhe tregon se do të jemi në gjendje të zgjidhim shumë çështje së bashku. “Jam shumë i kënaqur me takimin dhe marrëveshjen dhe mendoj se kemi shumë për të bërë së bashku”, tha Keir Starmer.

Christian Mickowski tha se marrëveshja parashikon investime britanike prej 6 miliardë eurosh në Maqedoninë e Veriut, kryesisht për ndërtimin e projekteve të infrastrukt

BRITANIA DHE MAQEDONIA E VERIUT ARRIJNË MARRËVESHJE PËR PARTNERITET STRATEGJIK



turës. “Me këtë marrëveshje ndërqeveritare, jam i bindur se do të kemi një

bashkëpunim edhe më të madh dy-palësh, do të forcojmë lidhjet tona dhe do të ndajmë përvojën e Mbretërisë së

Bashkuar në këtë pjesë të BE-së, pasi besoj se Ballkani është një vend që ofron mundësi”, shtoi Kryeministri i

Maqedonisë së Veriut.

Kryeministrat e Mbretërisë së Bashkuar dhe Maqedonisë së Veriut u takuan sot në Tiranë, në kuadër të Samitit të Komunitetit Politik Evropian.

Kryeministri i Mbretërisë së Bashkuar tha nga Tirana se vendi i tij ka filluar bisedimet me qeveritë e vendeve të tjera për ngritjen e “qendrave të kthimit” për migrantët, kërkesat e të cilëve për azil janë refuzuar në Britani.

Sipas gazetave britanike “The Times” dhe “Telegraph”, vëmendja e Britanisë për krijimin e qendrave të tilla të emigrantëve është përqendruar kryesisht në Serbi, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Maqedoninë e Veriut.

THE TIMES: PAS REFUZIMIT NGA SHQIPËRIA, STARMER DO T’I KËRKOJË KOSOVËS TË PRANOJË NGRITJEN E KAMPEVE TË EMIGRANTËVE

Britania do t’i kërkojë Kosovës të pranojë migrantët që mbërrijnë me varka të vogla si pjesë e planeve për të hapur një seri “qendrash kthimi” jashtë vendit, ka zbuluar gazeta The Times.

Shteti i Ballkanit Perëndimor është në një listë të shkurtër prej nëntë vendesh të përpiluar nga ministrat dhe zyrtarët si destinacione të mundshme për qendra jashtë vendit, ku do të dërgoheshin azilkërkuesit e refuzuar pasi të kenë shtuar të gjitha mundësitë e apelimit në Mbretërinë e Bashkuar. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka deklaruar gjithashtu se vendi i saj do të ishte “i hapur” për bisedime mbi një marrëveshje të mundshme për të pranuar azilkërkuesit e dështuar të Britanisë. Kosova i bashkohet Serbisë, Maqedonisë së Veriut, Bosnje-Hercegovinës dhe disa vendeve jashtë Evropës që janë përfshirë në listën e vendeve me të cilat ministrat synojnë të hapin negociatën.

Nuk kanë nisur ende bisedime zyrtare me asnjë vend, por besohet se ministrat dëshirojnë të kenë bërë përparim deri në momentin kur Britania të presë një takim të liderëve të Ballkanit Perëndimor në Londër këtë vjeshtë, ku emigracioni i paligjshëm do të jetë në krye të axhendës.

Ministrat kishin shpresuar që Shqipëria do të pranonte të strehonte

një nga qendrat e kthimit të Britanisë, por kryeministri Edi Rama e përjashtoi këtë javën e kaluar.

Burime të larta qeveritare thanë se Kosova është një vend “i mundshëm” për ngritjen e një qendre kthimi, pasi ndodhet në një rreth nga rrugët kryesore që përdorin emigrantët e paligjshëm drejt Bashkimit Evropian. Sipas Zyrës së Jashtme britanike, gati 22,000 emigrantë të paligjshëm përdorën rrugën e Ballkanit Perëndimor për të hyrë në BE vitin e kaluar.

Prova që emigrantët kalojnë përmes vendit pritës të qendrave të kthimit shihet si një hap kyç për të lehtësuar procesin ligjor të deportimit. Britania e Madhe do të mund të argumentonte se ata kishin mundësinë të kërkonin azil në një vend “të sigurt”, por zgjedhën të mos e bënin këtë.

Më shumë se 3,000 emigrantë hynë në BE pasi kaluan përmes Ballkanit Perëndimor në katër muajt e parë të këtij viti, përfshirë 804 vetëm në prill, sipas Frontex-it, agjencisë kufitare të BE-së. Afganët, turqit dhe sirianët përbënin numrin më të madh të mbërritjeve.

Keir Starmer po përballet me presion në rritje për dështimin e tij në frenimin e numrit gjithnjë e më të madh të emigrantëve që mbërrijnë me varka të vogla. Një rekord prej 13,573 emigrantësh kanë mbërritur deri tani me varka të vogla, 37 për qind më shumë

krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Kosova, një nga vendet më të varfra në Evropë, ka një popullsi prej rreth 1.6 milion banorësh dhe kufizohet me Serbinë në veri dhe lindje, Maqedoninë e Veriut në juglindje, Shqipërinë në jugperëndim dhe Malin e Zi në perëndim.

Presidentja Osmani tha javën e kaluar se vendi i saj do të ishte i hapur për idenë e strehimit të një prej qendrave të kthimit të Britanisë. “Nuk ka pasur bisedime zyrtare me Britaninë për këtë çështje. Nuk është ngritur deri më tani,” tha ajo.

“Do të ishim të hapur për ta diskutuar, megjithatë nuk mund të them më shumë sepse nuk i di detajet. Nuk mund të jap një përgjigje për një kërkesë që nuk është bërë ende.”

Disa vende të tjera evropiane po shqyrtojnë gjithashtu ngritjen e qendrave të jashtme për emigrantët e paligjshëm, përfshirë Italinë, Danimarkën, Gjermaninë, Holandën dhe Zvicrën.

Çdo marrëveshje do të kërkonte që Britania të paguajë për çdo azilkërkues të dështuar të zhvendosur. Kosova ka treguar gatishmërinë për të arritur marrëveshje ndërkombëtare për të pranuar emigrantët e padëshiruar të Evropës. Në vitin 2021, ajo ra dakord për një marrëveshje prej 200 milionë eurosh me

Danimarkën për të pranuar 300 të burgosur të huaj, të cilët do të vuajnë pjesën tjetër të dënimit të tyre në Kosovë deri sa të deportohen në vendet e tyre të origjinës — edhe pse kjo marrëveshje nuk është zbatuar ende.

David Lammy, sekretari i Jashtëm i Britanisë, vizitoi Kosovën muajin e kaluar, ku arriti një marrëveshje për të furnizuar teknologji britanike me qëllim që të ndalohet përdorimi i vendit nga grupet e kimit të organizuar për kontrabandimin e mallrave të paligjshme dhe emigrantëve drejt Britanisë.

Bashkimi Evropian njoftoi në mars se miraton që shtetet anëtare të ndjekin krijimin e qendrave të kthimit, dhe thuhet se Starmer është i interesuar të bashkëpunojë me vende të tjera evropiane. Holanda është në negociatë me qeverinë e Ugandës për hapjen e një qendre të tillë kthimi.

Gjatë një vizite në Shqipëri në fillim të këtij muaji, kryeministri konfirmoi se qeveria britanike po ndjek idenë e ngritjes së qendrave të kthimit, duke shtuar: “I shoh ato si një risi shumë të rëndësishme.”

Muajin e kaluar, The Times zbuloi se koncepti i qendrave të kthimit kishte marrë miratimin e UNHCR-së, agjencisë së Kombeve të Bashkuara për refugjatët — një zhvillim që u përshkrua si “ndryshim loje” nga burime

qeveritare.

Yvette Cooper, sekretarja e Brendshme, diskutoi mundësinë e pagesës së vendeve të Ballkanit për të pranuar azilkërkuesit e dështuar të Britanisë gjatë një takimi me Filippo Grandi, Komisionerin e Lartë të OKB-së për Refugjatët. Mbështetja e UNHCR-së për këto qendra shihet si thelbësore për realizimin e tyre, pasi ndërhyrja e saj në Gjykatën e Lartë kundër skemës së qeverisë konservatore për deportimin në Ruandë çoi përfundimisht në shpalljen e saj si të paligjshme.

Planet e Laburistëve do të ndryshonin nga skema e mëparshme e deportimit të konservatorëve drejt Ruandës, e cila synonte të dërgonte emigrantët e paligjshëm në atë vend afrikan me një fluturim njëdrejtimësh brenda disa ditëve nga mbërritja në Britani pa e dëgjuar kërkesën e tyre për azil. Kjo skemë u anulua si një nga veprimet e para të Starmer-it si kryeministër.

Burimet qeveritare kanë përjashtuar mundësinë e ngritjes së një qendre kthimi në Ruandë, pasi Partia Laburiste nuk e konsideron atë si një vend të sigurt. Sipas këtyre burimeve, çdo qendër kthimi duhet të plotësojë tre kriteret e vendosura nga Starmer: të jetë “e përballueshme, e zbatueshme dhe ligjore.”/The Times

AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

AKOMA NUK JENI REGJISTRUAR NË GOOGLE?

Për çdo konsultim mund te vini në zyrat tona
30 Avenons Road, London E13 8HT



020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545



#BreakingTheChains

Forest Gate Youth Club

Immigration advise

Sports & Dancing

Peer support

General info and support


Come Dine with Me



Join us

every Monday evening 6-9pm

 1 Woodford Road,
Forest Gate,
London, E7 0DH

 07494974957


Shpresa Programme

Inspiring hope & change



SHISHA BAR PËR SHITJE

**-I HAPUR PREJ
VITESH**

**-ME KLIENTELE TË
GARANTUAR**

**-I PAJISUR ME TE
GJITHA LIÇENSAT**

**-ÇMIMI SHUMË I
ARSYESHËM**

**-PËR MË SHUMË
INFO NA**

KONTAKTONI

TEL: 07557565437



ENVER ROBELLI

NJË JETË E NDARË ME TELA GJEMBORË

Si u zhvilluan marrëdhëniet mes shqiptarëve të mbetur në Jugosllavi dhe shqiptarëve të Shqipërisë, si u mundësuan shkëmbimet kulturore, si përfunduan në burgje ata që shpresonin të gjenin “parajsën shqiptare”? Këtyre pyetjeve rreket t’u përgjigjet filmi dokumentar “Kufiri i kuq - Të huaj mes t’vetëve”. Këtij filmi duhet dëshiruar shumë shikuese e shikues në Kosovë, në Shqipëri dhe kudo ku jetojnë shqiptarë, përfshirë diasporën. Autorët kanë bërë një punë e vyer për të dokumentuar një segment të rëndësishëm të historisë ndërshqiptare.

Në vitin 1946 politikani britanik, Winston Churchill, kryeministër mes viteve 1940-45, foli për herë të parë mbi Perden e Hekurt që betanoi ndarjen e Europës midis vendeve komuniste dhe atyre demokratike. Afërsisht në atë kohë një Perde tjetër e Hekurt u vendos mes shqiptarëve të mbetur në Jugosllavi dhe Shqipërisë, ku një grusht komunistësh me mbështetje masive nga Beogradi nisi rrugëtimin drejt vendosjes së themeleve të një diktature brutale me tipare koreanovore.

Më 1946, në kulmin e vëllazërisë së komunistëve shqiptarë me ata jugosllavë, diktatori i ri Enver Hoxha tha: “Jugosllavia demokratike është më e avancuar, më e përparuar se ne. Interesi ynë është që ajo të jetë e fortë, se me një Jugosllavi të fortë do të ketë demokraci në Ballkan. A është në interesin tonë të kërkojmë Kosovën? Kjo nuk është progresiste”.

Ndonëse më 1948 Enver Hoxha dhe lideri komunist jugosllav Josip Broz Tito i ndanë rrugët - i pari i qëndroi besnik diktatorit sovjetik Stalin, i dyti e kundërshtoi atë -, Enver Hoxha e ruajti respektin për Titon, siç e dëshmoi e veja e tij Nexhmije Hoxha në një intervistë me revistën gjermane “Der Spiegel” më 2004: “Ndonëse më vonë Tito u bë kryeamiku ynë ideologjik, burri im (Enver Hoxha, v.j.) e respektoonte atë si faktor stabiliteti në Ballkan. Kur Tito u sëmur për vdekje, Enveri më befasoi me këto fjalë: ‘Kam pasur dëshirë që ai të jetonte edhe disa vite’”. Gjatë sundimit të tij Enver Hoxha iu përmbajt porosisë që ia kishte dhënë Stalini më 1949 gjatë një takimi në Sukumi pranë Detit të Zi: “Çështja e Kosovës duhet të lihet në plan të dytë dhe nga ana juaj të mos vihet në plan të parë”.

Për të mbrojtur regjimin e tij, Hoxha mund të llogariste në mbështetje nga Jugosllavia. “Shqipëria e Veriut ka mbetë reaksionare dhe ta bashkosh Kosovën me Shqipërinë e Veriut do të thotë ta mbyshish me lehtësi Luftën Nacional Çlirimtare dhe Qeverinë e Enver Hoxhës”, deklaroi Predrag Ajtiqi në të ashtuquajturën Konferencë e Prizrenit (mars 1945), ku “u vendos” që Kosova të mbetet pjesë e Serbisë. Ajtiqi ka qenë funksionar komunist jugosllav dhe serb i Prizrenit. Në korrik të vitit 1954 Ajtiqi



u emërua ambasador i Jugosllavisë në Tiranë. Regjimi i Hoxhës nuk pati asnjë vërejtje ndaj tij. Kështu ishte “politika e lartë”.

E si ishte jeta e përditshme, si ishin dhe si u zhvilluan marrëdhëniet mes shqiptarëve të mbetur në Jugosllavi dhe shqiptarëve të Shqipërisë, si u mundësuan shkëmbimet kulturore? Këtyre pyetjeve rreket t’u përgjigjet filmi dokumentar “Kufiri i kuq - Të huaj mes t’vetëve” me skenar të Admirina Peçit dhe regji të Rezart Shehut. Këtij filmi duhet dëshiruar shumë shikuese e shikues në Kosovë, në Shqipëri dhe kudo ku jetojnë shqiptarë, përfshirë diasporën. Shumëçka mund të mësohet prej tij.

Më 1955 në Tiranë u arrestua një grup liceistësh për shkak se guxuan të përkrahnin hapur Kosovën si pjesë të Shqipërisë etnike. I inspiruar nga kjo ngjarje poeti Arshi Pipa shkroi poezinë “Kosova”, ku që në strofën e parë përshkruhet zymtësia që imponoi regjimi komunist në Shqipëri: “Vllazën shqiptarë, Kosova s’asht e jona. / Kush me e përmendë guzon ai ban trathiti! / O kob qi s’do t’harrohet kurr tevona! / Kosova e ngratë dergjet e vdes n’robni”.

Se çfarë do të thoshte kjo në përditshmëri e tregon shkrimtari Primo Shllaku. Mesazhi i Beogradit në drejtim të Tiranës, sipas tij, ishte ky: ne nuk përzihemi në punët tuaja, ju mos u përzieni në punët tona (lexo: në çështjen e pazgjidhur të Kosovës). Kështu, shton Shllaku, u nda historia mes dy pjesëve të një kombi.

Por lidhjet s’mund të këputeshin. Kishte njerëz në Kosovë që

rrezikonin, kalonin telat me gjemba në kufi dhe shkonin në Shqipëri me pritje të mëdha. Kritiku Behar Gjoka përmend në film disa personalitete nga Kosova që me ardhjen e tyre në Shqipëri si të thuash me vetë praninë e tyre i dëshmuar shoqërisë shqiptare se matanë Vermoshit, Kukësit dhe Pogradecit jetonin po ashtu shqiptarë.

Shumë prej tyre shiheshin me dyshim nga regjimi dhe funksionarët e kulturës në Tiranë. Gjuhëtari Selman Riza përfundoi në burg si në Jugosllavi ashtu edhe në Shqipëri. Mbi këtë rrugë të vështirë të Rizës, profesor Rexhep Ismajli ka shkruar një punim brilant (“Pasionet dhe pësimet e Selman Rizës”), botim i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, 2009). Agim Gjakova ishte autor me talent dhe, sipas Behar Gjokës, ai përmendje bashkë me Ismail Kadarenë, Dritëro Agollin, Fatos Arapin - “por atë e ndiqte hija e ardhjes”. E ardhjes nga Kosova. Kjo ishte një lloj damke.

Një çmim shumë të shtrenjtë e pagoi edhe Sadri Ahmeti, më vonë një piktor i njohur. Më 1957 ai u arratis nga Mali i Zi në Shqipëri, bashkë me tre vëllezërit e tij. Nuk e gjeti parajsën e imagjinuar, por burgun. Për një muaj u mbajt i izoluar dhe nën presion për të pranuar se është agjent i shërbimeve jugosllave. U dërgua në një kamp në Llakatund të Vlorës. Kur, më në fund, iu dha e drejta për të studiuar, prapë Sigurimi famëkeq nuk e la të qetë. I kërkuan të shkruajë 70 faqe kundër shokëve të tij. Sadri Ahmeti, me prejardhje nga Vuthaj, i dorëzoi 70 faqe pa asnjë shkronjë në të. E arrestuan sërish “njeriun që vetëm buzëqeshte” (siç dëshmon në film Behar Gjoka).

Mbresëlënese është edhe dëshmia e shkrimtarit Nazmi Rrahmani, i cili me dekada drejtoi botimet e ndërmarrjes “Rilindja” të Kosovës dhe ndërtoi urat e para të bashkëpunimit kulturor mes Prishtinës dhe Tiranës. Duket e pabesueshme sa shumë vjet kaluan derisa regjimi komunist në Tiranë lejoi botimin e librave të autorëve nga Kosova. Tek më 1970, pra 25 vjet pas Luftës së Dytë Botërore, dolën në Tiranë romani “Malësorja” i Nazmi Rrahmanit dhe një vëllim me poezi me titullin “Për ty”. Këto janë dy veprat e para të shkrimtarëve shqiptarë të Kosovës që panë dritën e botimit në Tiranë.

Në atë kohë “Rilindja”, sipas Nazmi Rrahmanit, importonte rreth 50 libra në vit nga Tirana me 1000 deri 5000 kopje. Shqipëria ishte shumë restriktive dhe importonte pak libra nga Kosova. Dyshimi ishte i madh, sidomos ndaj shkrimtarëve si Anton Pashku, të cilët etiketoheshin si dekadentë që shkruanin “vargje të paqarta” (sipas një dokumenti të censurorëve komunistë të Shqipërisë).

Bashkë me një grup autorësh të rinj, Pashku i shpalli luftë realizmit socialist nëpërmjet një manifesti të botuar më 1971. I ndikuar nga letërsia franceze e sidomos nga përfaqësuesit të antiromanit si Nathalie Sarraute, André Gide, Alain Robbe-Grillet dhe Michel Butor, Anton Pashku shkroi romanin “Oh”, një përpjekje për ta lidhur letërsinë shqiptare me trendet letrare të Europës perëndimore. Jo vetëm ky eksperiment letrar i pengonte censurorët në Tiranë. Nuk shihej me sy të mirë as të shkruarit në gegnisht, siç e kishte praktikuar Anton Pashku te romani “Oh”.

Më 1973 në Shqipëri mori fund faza shumë e shkurtër e liberalizmit në fushën e kulturës. Gjatë vizitës në Tiranë Nazmi Rrahmani vëren me tronditje se “njerëzit nuk dëshironin të takoheshin”, ata nga frika e devijonin rrugën kur shihnin autorë nga Kosova.

Shqipëria vendosi të thellojë raportet me Kinën dhe të zgjerojë revolucionin kulturor sipas modelit kinez. Kjo zgjati deri më 1978, kur Kina dha sinjale se dëshironte të afrohej me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në dhjetor të atij viti u paralajmërua vizita e liderit komunist kinez, Teng Hsiao-ping, në SHBA. Në fund të janarit dhe në fillim të shkurtit 1979 Teng Hsiao-ping vizitoi Washingtonin dhe disa shtete amerikane.

Në Atlanta kryekomunisti kinez vizitoi fabrikën e Coca Colas dhe nënshkroi një marrëveshje për t’i lejuar kompanisë së famshme amerikane hyrjen në tregun kinez. Enver Hoxha e quante tradhti ndaj komunizmit kursin e ri politik të Teng Hsiao-pingut. Këtu mori fund “vëllazëria shqiptaro-kineze”.

Tani Enver Hoxha, kundërshtari i madh i kapitalizmit dhe Coca Colas, vendosi të luajë rolin e nacionalistit. Më 1979 Kosovën e vizitoi shkrimtari i njohur Ismail Kadare. Në prill të atij viti Orkestra Simfonike e Radiotelevizionit Shqiptar nisi një turne 17-ditor nëpër Kosovë. Dejanira Cara, violonçelite, e kujton këtë udhëtim në filmin “Kufiri i kuq - Të huaj mes t’vetëve”.

Rrëfimi i saj shpalos një botë që nga këndvështrimi i sotëm duket surrealist. Në Prishtinë Dejanira Carës i bëri përshtypje nata e bukur, qyteti gjithë drita, “Tirana në atë kohë ishte erësiere”, thotë ajo. Pastaj Cara përshkruan ambientin në Hotelin Grand, në atë kohë një godinë që duhej të simbolizonte modernizmin e Kosovës. “Ishte një banak i madh (në Hotelin Grand), s’kishim parë ndonjëherë, vetëm në filma, s’e mendonim se mund të ketë edhe në Kosovë”, tregon Dejanira Cara. Kur artistët ishin nisur nga Tirana, ata kërkuan të blejnë pemë për rrugë, por “s’kishte asgjë”: “Dyqani afër Grandit kishte peme, perime, banane, që ne nuk i kishim parë ndonjëherë”.

Këto dëshmi janë të vlefshme jo për të ilustruar gjoja epërsinë e njërës apo palës tjetër, por për të shpalosur një botë në të cilën jetonin shqiptarët në Ballkan në atë kohë - një botë me kufij, me pengesa, me varfëri, me shtypje. Disa protagonistë në film nuk mund t’i ikin patetizmave apo rrëfimeve anekdotike pa fakte, por në tërësinë e tij filmi “Kufiri i kuq - Të huaj mes t’vetëve” është një punë e vyer për të dokumentuar një segment të rëndësishëm të historisë ndërshqiptare.

SONILA MEÇO

KLORI I GARDHIT, VOTA E GETOS

Dy ngjarje sot

1. Në një vend ku GDP për frymë është më poshtë se e Bosnie-Hercegovinës, ndërtohet një “pishinë gjigande”, një ndër 10 më të mëdhatë në botë.

Më doli një video promovuese në “shëtitjen” ditore në instagram. Shqipëria në statistikën botërore me një ndër 10 pishinat më të mëdha e më të bukura në botë.

Bukur. Ç’thotë tjetër statistika mor amani? Po ja, siç shihet në grafik, vendi më i varfër në Europë, sipas Eurostat, FMN, BB.

Po ç’Shqipëri është kjo, ta kuptojmë cazë?! Shqipëri e “gardhit” të luksit dhe “getove” të popullit.

Jashtë gardhit, gjysma e popullsisë jeton me më pak se 5 euro në ditë, por pse të mos e mbulojmë varfërinë me klor? Le të ndërtojmë dhe një resort skish në Sarandë, pistën më të madhe të patinazhit në Ksamil, kanale për gara me kajak tek Komuna e Parisit, mjafton të duket bukur në drone dhe në profilin e kryeministrit.

Shumë mirë, do të kemi resorte, kulla dhe pishina gjigante për turistë, por do të jemi vend pa arsim (e ç’do na duhet kur kemi ChatGPT), pa shëndetësi (por me teorinë e Adhamudhit ama: “Të dhemb njëri sy? Kërreje të shpëtosh tjetrin”), pa industri prodhuese (kemi mishin e Brazilit, qumështin e Serbisë, kumbullat e Afrikës).

Populli jashtë gardhi të shohë reality, instagramin e kryeministrit, të votojë që në 8 të mëngjesit e të mallojë opozitën. Të rrijë në tik tok me vpn, të ikë në emigracion, ose të shajë në facebook mendjet e lira.



Klasa e mesme të shndërrohet në relike. Një grusht njerëzish të bëhen të pasur jo se kanë shpikur diçka, jo se kanë ndërtuar një biznes real, por sepse kanë lidhje me pushtetin, krimin ose sistemin.

Shqipëria po “eksporton” trurin dhe po “importon” më shumë arkitektë për kulla pa banorë dhe resorte për video instagrami.

Përfundimisht këtu nuk po ndërtohet ekonomi, por skenografi për një vend që nuk ekziston. Gjithçka duket sikur po ecën: ndërtime, makina, investime. Por në thelb është një skenografi. Pas saj nuk ka zhvillim, por larje hesapësh, fatura fiktive dhe korrupsion që ndryshk gjithçka përbrenda. Ky është një

dëm sistemik: kapitali nuk është më mjet zhvillimi, por instrument manipulimi.

Ndërsa shumica e vendeve moderne ndërtojnë ekonomi me dije, teknologji, industri të qëndrueshme, Rilindja ka zgjedhur: beton, turizëm sezonal, “investitorë strategjikë” që ndodhin të kenë lidhje me parajsat fiskale.

Dhe as 5 minuta pas mahnitjes me pishinën më të madhe në vendin më të varfër në Europë shfaqet në kuturinë virtuale ngjarja tjetër:
2. Kryeministri Edi Rama, zhvilloi një bashkëbisedim me producentin Richard Attias, një prej organizatorëve të Forumit Ndërkombëtar FII.

Aty paska deklaruar se: “Ndoshta fitoj, sepse s’jam një socialist i mirë.”

Absolutisht Po! Për këtë fiton. Sepse ka arritur me makinerinë e vet të ndërsyer elektorale t’i bëjë njerëzit mos të votojnë për mirëqenie, por mbijetesë.

Rama ka kohë që ka transformuar Partinë Socialiste nga një forcë tradicionale e majtë në një parti të stilit personal dhe menaxherial. Ai nuk kërkon të duket si trashëgimtar i ideologjisë socialiste klasike (barazi, rishpërndarje, mbrojtje sociale). As nuk e grish kjo gjë. As nuk e ka dashur kurrë këtë.

Sa e sa herë thosh, nuk jam politikan, mandej përtej së majtës e së djathtës. Ka thënë të vërtetën, sepse për të, partia është mjeti, që i siguron pushtetin e me të të mund ngopë delirin e autokratit, që bën gjëra të mëdha, me kosto kolosale. E t’i japë mend Europës, që në realitet e sheh nga poshtë lart në listën e vendit më të varfër në Europë. Sikur të ekzistonte mënyrë tjetër për të marrë pushtetin, patjetër do zgjidhte të evitonte kokëçarjet me parti, zgjedhje, sistem politik, parlament...

Vota ka mbetur, asaj i është turrur. Dhe as e kërkon si socialist, as si i majtë, as si menaxher publik. E merr siç e marrin autokratët mentorë të tij. Por me ca “ndihma” tipike realiteti unik shqiptar. Ku hyjnë edhe krimi i organizuar edhe periferia gjeopolitike.

Pra një realitet si ai shqiptar, ku njerëzit përballen me pasiguri ekonomike, varfëri, mungesë shërbimesh dhe besim të ulët në sistem, vota shpesh shndërrohet nga akt politik në akt mbijetesë.

Manipulimi elektorale nuk është vetëm “blerje vote”, por është infrastruktura monsturoze ndikimi.

E tillë, që mund të krekoset edhe me pishina, kulla, fasada e luks sipërfaqësor, ndërsa paguan skenografi e kopertina me një vend të vogël pa ekonomi, pa prodhim, pa inovacion, pa arsim, pa shëndetësi, pa ushtri, të marrë peng si parajsa e krimin dhe ferri i popullit.

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners

Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946



BRITANIKËT: RAMA TURPËROI KEIR STARMERIN NË TIRANË!

Vizita e Kryeministrit britanik Keir Starmer në Shqipëri është shndërruar në një fiasco të vërtetë politike dhe mediatike në Mbretërinë e Bashkuar. Shtypi britanik dhe opozita konservatore po e përshkruajnë udhëtimin e tij në Tiranë si “një moment poshtëruar”, ku një ide që synonte të dukej si një strategji e fortë për frenimin e emigracionit të paligjshëm u përmbys brenda orës, dhe për më tepër në transmetim të drejtpërdrejtë nga vetë mikpritësi i tij, Kryeministri Edi Rama.

Daily Mail e quan këtë një “goditje të turpshme” për Starmer, i cili u përpoq të promovonte një plan për ngritjen e qendrave të ngjashme me modelin e Ruandës në vende të treta, për të strehuar azilkërkues të dështuar nga MB-ja. Por Rama i bëri të qartë, në konferencë për shtyp, se Shqipëria nuk do të jetë pjesë e asnjë marrëveshjeje të re të tillë – duke e bërë vizitën të duket e pakuptimtë dhe duke e ekspozuar Starmer si të papërgatitur diplomatikisht.

Shkrimi i plotë i Daily Mail:

Keir Starmer përjetoi dje një poshtërim për shkak të përpjekjes së tij të fundit për të goditur emigracionin e paligjshëm.

Në një lëvizje të papritur, Kryeministri britanik përdori vizitën e tij në Shqipëri për të shpallur planet për krijimin e qendrave të ngjashme për refugjatët e paligjshëm me ato të Ruandës në vende të huaja, ku do të strehoheshin azilkërkuesit e dështuar nga Mbretëria e Bashkuar.

Por kjo nismë u shemb përpara kamerave, vetëm një orë më pas, kur mikpritësi i tij, kryeministri shqiptar Edi Rama, e përjashtoi publikisht çdo pjesëmarrje të Shqipërisë në këtë skemë.

Plani i Starmer përbën një kthesë të



madhe nga qëndrimi i tij i mëparshëm, pasi kishte quajtur skemën e Ruandës të qeverisë së kaluar një “truk politik”, të cilën e anuloi brenda pak ditësh pas ardhjes në pushtet. Në një konferencë për shtyp në Tiranë, Rama – i cili është 2 metra i gjatë dhe qëndronte fizikisht dhe politikisht mbi Starmer – u shpreh: “Kam qenë shumë i qartë që nga dita e parë kur e nisëm këtë proces me Italinë, se ishte një marrëveshje e vetme, për shkak të marrëdhënies sonë të ngushtë dhe për shkak të situatës gjeografike që e bën të logjikshme.” Ai shtoi më pas “Na kanë pyetur disa vende nëse ishim të hapur për marrëveshje të tjera dhe ne u thamë ‘jo’, sepse jemi besnikë ndaj martesës me Italinë – dhe pjesa tjetër është vetëm dashuri.”

Sekretari i Brendshëm në hije, Chris Philp, e quajti këtë një dështim diplomatik të rëndë: “Kjo vizitë është një turp. Starmer fluturoi deri në Shqipëri dhe kryeministri shqiptar e bëri të qartë që nuk do të ketë qendra britanike kthimi në Shqipëri. Pra, cili ishte qëllimi i kësaj vizite?” Ai shtoi: “Një nga veprimet e para të kësaj qeverie laburiste ishte të anulonte planin për Ruandën. Tani, ndërkohë që 2025 po rezulton të jetë viti më i keq ndonjëherë për kalimet ilegale përmes Kanalit, Kryeministri po përpiqet të vërë në punë një imitim të dobët të atij plani. Starmer nuk është shqetësuar kurrë për ndalimin e emigracionit të paligjshëm... tani është në panik total dhe po shpik politika të papjekura për të mbuluar kaosin.”

Ky dështim për Starmer vjen në një moment kur ai përpiqet të shfaqet i ashpër për emigracionin për të frenuar rritjen e partisë “Reform UK”, ndonëse për vite me radhë kishte mbrojtur qëndrime të kundërta. Zyrtarët e qeverisë mbremjen e djeshme këmbëngulnin se qendrat e kthimit mund të negociohen ende me vende të tjera të Ballkanit si Serbia, Bosnja dhe Maqedonia e Veriut. Ministri po shqyrtojnë gjithashtu mundësinë e marrëveshjeve me disa shtete afrikane – përjashtuar Ruandën. Starmer u përpoq të minimizojë refuzimin publik nga Shqipëria, duke thënë se nuk ishte gati të publikonte emrat e vendeve me të cilat po negocionin Britania. Zyrtarët tentuan të sugjerorin se nuk kishte pasur kurrë plan

që Tirana të përfshihej, edhe pse ai udhëtoi pikërisht atje për ta shpallur planin.

“Në kohën e duhur do të jap më shumë detaje për këtë çështje,” tha Kryeministri pas deklaratës refuzuese të Ramës.

Para takimit me Ramën, Starmer kishte thënë se tani ishte në favor të pagesës për të dërguar azilkërkuesit e dështuar jashtë vendit.

“Ajo që ne duam të bëjmë dhe për të cilën po zhvillojmë diskutime, është ngritja e qendrave të kthimit – vende ku një person që ka kaluar të gjitha procedurat ligjore në MB, duhet të kthehet dhe ne duhet të sigurohemi që kjo të ndodhë. Dhe do ta bëjmë këtë, nëse mundemi, përmes qendrave të kthimit” u shpreh ai.

Downing Street deklaroi se planet e reja janë “krejtësisht të ndryshme” nga skema e Ruandës së qeverisë së kaluar. Por vendimi për të negociuar pagesa për dërgimin e azilkërkuesve në vende të treta mund ta bëjë Kryeministrin të duket hipokrit, pasi po ndjek në thelb të njëjtën rrugë që më parë e quante të papranueshme.

Ministrat janë tani në përpjekje për të gjetur një zëvendësues të frikshëm për kalimet me gomone, pas një rritjeje të ndjeshme të emigrantëve ilegalë që kur Laburistët erdhën në pushtet. Deri më tani, në vitin 2025 kanë mbërritur mbi 12,000 persona, një rritje me 40% krahasuar me 2024. Të hënën, më shumë se 600 kaluan Kanalin – në të njëjtën kohë që Kryeministri po mbante një fjalim për ndalimin e emigracionit/ Daily Mail Përshtati Lapsi.al

SHQIPTARËT, TË DYTËT MË TË REFUZUARIT NË KUFIJTË E BE NË 2024

Shqiptarët janë të dytët më të refuzuarit në kufijtë e Bashkimit Europian, pas ukrainasve (19 595).

Në total në kufijtë tokësor, ajror dhe detar në vitin 2024 janë refuzuar 14,260 shtetas shqiptar, ku gjysma në kufijtë tokësorë (7855).

Gjysma e totalit janë refuzuar në shtet fqinjë, Greqi dhe Itali, ndërsa pjesa tjetër e shpërndarë në Lituani, Hungari, Gjermani etj.

Për çfarë janë refuzuar kryesisht shqiptarët?

Sipas Eurostat shtetasit shqiptarë u refuzuan kryesisht (14 260) për shkak të “Është lëshuar një sinjalizim/alert[i]” (28,8 %) dhe “Qëllimi dhe kushtet e qëndrimit nuk janë të justifikuar” (27,2 %).

Pas shqiptarëve më të refuzuarit renditet moldavët (12 100), turqit (6 760) dhe serbët (6 190).

Kthimet e shtetasve të vendeve të treta

Në vitin 2024, numri i shtetasve të vendeve të treta të kthyer në një vend


të tretë u rrit me 19.3%.

Në vitin 2024, 110 385 shtetas të vendeve të treta që morën urdhër për t’u larguar nga një vend i BE-së u kthyen në një vend të tretë, që përfaqëson 88,1% të kthimeve totale (d.m.th. duke përfshirë edhe kthimet në një vend tjetër të BE-së).

Shtetasit e Gjeorgjisë përbenin numrin më të madh të kthimeve në BE me 11 585 prej tyre të kthyer në një vend të tretë. Ata u pasuan nga turqit (7 910), shqiptarët (7 810), moldavët (4 970) dhe kolumbianët (4 930).

Të refuzuarit në Europë të vendeve të treta u refuzuan të hynin në territorin e BE-së në njërin prej kufijve të saj të jashtëm, një rritje e lehtë prej 0,3% krahasuar me 2023-in.

Top 20 citizenship of third-country nationals refused to entry into the EU, by type of border, 2024



918 925 persona u konstatuan se qëndronin në mënyrë të paligjshme në një vend të BE-së, çka përfaqëson një rënie prej 27,4 % krahasuar me 1,27 milion të tillë në vitin e mëparshëm. Numri i shtetasve të vendeve të treta ndaj të cilëve është lëshuar urdhër

regjistruan në Poloni (16.7%) dhe në Kroaci (11.3%).

Numri më i madh i refuzimeve të regjistruara në kufijtë e jashtëm tokësor u raportuan nga Polonia (18 030; 87.2% e të gjitha refuzimeve të hyrjes në Poloni), Kroacia (13 535; 97.0%), Rumania (8 960; 88.2%), Hungaria (6 205; 0.5; 89%) dhe Greqia (85 %). 170; 78.2%).

largimi nga një vend i BE-së ishte 453 380, një rënie prej 7,3 % krahasuar me 2023-in (489 335).

Në vitin 2024, s h u m i c a (56.9%) e shtetasve të vendeve të treta të cilëve iu refuzua hyrja në BE ishin përmes kufijve të jashtëm tokësorë të BE-së, të ndjekura nga refuzimet në kufijtë ajror (39.8%), ndërsa vetëm një pjesë e vogël (3.4%) e refuzimeve totale ishin në kufijtë detarë.

Pothuajse një e treta e numrit të përgjithshëm të refuzimeve u

Për sa i përket kufijve ajror, në vitin 2024 Franca raportoi numrin më të madh të refuzimeve (7 800) në BE, e ndjekur nga Gjermania (6 935), Irlanda (6 240) dhe Spanja (5 650) në vitin 2025.

Italia (1 320) raportoi numrin më të lartë të refuzimeve në kufijtë detarë të BE-së në vitin 2024, e ndjekur nga Franca (1 145)/Monitor

ÇFARË TREGON ZBULIMI I NJË GRUPI NARKOTRAFIKANTËSH PËR ZGJEDHJET E 11 MAJIT

ANDI BUSHATI

Goditja nga antimafia italiane e atij që u konsiderua si një nga grupet më të rrezikshme të narkotrafikut në vend, më shumë sesa një lajm kronike është një tjetër njollë politike në kurmin e përlyer të këtij pushteti.

Ky aksion më shumë se për të na faktuar se si vinte kokaina nga Amerika Latine, se si mbërrinte në portin e Durrësit, se si rishpërndahej prej aty në Itali e në mbarë Evropën dhe se si, pastaj, paratë e përfituara përfundonin të pastroheshin në Shqipëri, tregon tjetër gjë. Ajo nuk është thjeshtë një radiografi e organizatës kriminale të Troplinëve, por një dëshmi se si funksionon qeverisja e viteve të fundit dhe se si ia mbërrin ajo të konfirmohet pas çdo sfide elektorale.

Le ti marrim konkretisht me shembuj...

Lideri i PD, Sali Berisha disa herë para 11 majit e denoncoi këtë bandë se po intimidonte kandidatët e PD dhe po bënte hapur fushatë për PS-në. Reporterë të shumtë kanë pohuar se së paku dy nga anëtarët e listës së socialistëve për Durrësin janë njerëz direkt të saj. Por edhe sikur këto deklarata ti marrim me dyshim, faktet sërish janë kokëforta.

Në dosjen e prokurorëve të antimafias italiane dhe në pohimet e përmbartuesve të tyre shqiptarë del e qartë se një nga krerët e kësaj organizate ishte shpërblyer drejtpërdrejt nga Edi Rama me një leje ndërtimi. Elvis Doçi, i njohur si “Visi i Pojës”, nip i Xhevdet Troplinit, me kompaninë “Eldemar Construction”, tërësisht në pronësi të tij, ka fituar në Prill 2024, të drejtën për të ngritur një hotel dhjetë katësh në qytetin e Durrësit. Këtu çështja nuk është thjeshtë kush firmosi dhe cili përfitoi. Pyetjet shkojnë përtej: si po zhvillohet industria jonë e turizmit? Kush po investon në të? Dhe mbi të gjitha me çfarë parash? Pikërisht këtu vijmë tek një pikë tjetër. Sa herë që përballen me akuzat për pastrimin e parave të zeza në sektorin e ndërtimit në Shqipëri, pjestarët e qeverisë bëjnë të paditurin apo justifikohen se ato janë fryt i kursimeve të emigrantëve shqiptarë, se mungesa e kredithënies argumentohet me blerjen që në gropë, e broçkulla të tjera.



Dosja italiane na dëshmon me detaje, video dhe foto se si mbërrin në Shqipëri, në mënyrë klandestine përmes autobuzësh, paratë e drogës së shitur në Itali. Janë pikërisht këto para – që mbajnë të ulët kursin e euros – që shërbejnë si injeksione për ekonominë dhe që një herë në katër vite përcaktojnë edhe zgjedhjet.

Dhe ky nuk është një rast i izoluar. A nuk përfundoi në pranga deputeti deputeti socialist Jurgis Çyrbja i cili doli nga përgjimet e SKY se ishte njeriu i vendosur në listë nga bandat dhe madje spiuni për llogari të tyre në parlament?

Po kur u bë publike një pjesë e dosjes së grupit të Suel Çelës, në fund të vitit që shkoi, a nuk doli aty emri i një biznesmeni, Marsel Shega që e furnizonte organizatën me paratë e tenderave publikë, që merrte prej pushtetarëve socialistë. A nuk kishin arritur dy vëllezërit e arrestuar të kësaj bande të gradonin motrën e tyre Adelajda Roka drejt e në paradhomën e Edi Ramës, pikërisht si drejtoreshë të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, ku vendoset për lejet e ndërtimit?

Nuk është rastësi që edhe Troplinët edhe Çyrbja edhe banda e Suel Çelës,

për të mos përmendur shumë raste të tjera, janë të gjithë të akuzuar nga opozita si manipulorë të zgjedhjeve. As naiviteti ekstrem i idiotëve të dobishëm, që nuk duan ti shohnin të lidhura këto fakte, nuk mjafton për të mbuluar katërkëndëshin e përbërë nga hajdutë të votës, para të zeza, banda kriminale dhe favoreve me punë publike apo leje ndërtimi që u dhurojnë atyre rilindasit. Kjo është baza reale e pushtetit në Shqipëri.

Të papërfshira me të nuk ka si si të shihen as disa pikpyetje që janë ngritur në orët e fundit: Pse kur gjykata italiane i firmosi arrestimet që në shkurt, ato u ekzekutuan vetëm

tani? Mos vallë dhe Troplinët njësoj si Bajrat në zgjedhjet lokale, u lanë të lirë për të mbaruar punë me votën? Po “Visi i Pojës” si arriti të ikë në drejtim të paditur, ndoshta dikush i ktheu nderin e asaj që bëri në fushatë? Po Task forca qesharake e SPAK-ut që prezumohej ti kishte prej muajsh nën vëzhgim, nuk pa asgjë nga ato që po ndodhnin në Durrës, pavarësisht denoncimeve të atyre që bërtisnin: “Po na vjedhin?”

Pas dosjes që lexuam këto pyetje mbeten në ajër, ndonëse gjithmonë do të gjenden nga ata që “në mirëbesim” do të betohen se kjo nuk ka të bëjë me 11 majin.

AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

AKOMA NUK JENI REGJISTRUAR NË GOOGLE?



Për çdo konsultim mund te vini në zyrat tona
30 Avenons Road, London E13 8HT



020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545



AURENC BEBJA

Kur arsimtari, përkthyesi dhe poeti Beqir Haçi (1907 – 1990) shkruajti letrën në vijim, sigurisht që nuk e dinte për fatin tragjik që do t'i rezervohet vite më vonë nga regjimi komunist.


Revista amerikane “Junior Red Cross News” botoi në shtator të 1922, në letrën e tij kur ai ishte një djalosh 14 vjeçar, përmbajtjen e të cilës, Aurenc Bebjja, nëpërmjet Blogut “Dars (Klos), Mat – Albania”, e ka sjellë për publikun shqiptar :

Të dashur të Rinj,

Jo shumë kohë më parë, në vendin e vogël malor të Shqipërisë ishte një festë kombëtare, kur në Tiranë u hapën punimet për ndërtimin e një ndërtese të përhershme për Shkollën Profesionale Shqiptare (Albanian Vocational School) – një shkollë e bërë e mundur falë ndihmës së dhënë nga Kryqi i Kuq Amerikan për të Rinj. Kryeministri dhe zyrtarë të tjerë të Kabinetit ishin të pranishëm, si dhe diplomatë të vendeve të huaja, sepse ishte një rast i rëndësishëm. Shqipëria ishte e shtypur nga turqit për 500 vjet para Luftës Botërore dhe ishte mohuar shkolla e saj. Të shpërndarë nëpër male në fise, këta pasardhës të ilirëve të lashtë jetonin me pushkë dhe pistoletë gjithmonë pranë dhe shpesh luftonin mes tyre... Këtu filloi shkolla profesionale e Shqipërisë. Grupi muzikor amerikan, nga Worcester, Massachusetts, ishte i pranishëm dhe gjallëroi ceremoninë.

Shkolla Profesionale Shqiptare, në një godinë të përkohshme, ka rreth një vit që ekziston, me amerikanë të aftë që ju përfaqësojnë ju, Të Rinj, në krye të saj. Gjashtëdhjetë e katër djemtë që ndjekin këtë shkollë erdhën nga tetë krahina të Shqipërisë, janë anëtarë të fiseve të ndryshme dhe po mësojnë ideat e shërbimit dhe vullnetit të mirë që janë më të lartat në mendjet e

1922/LETRA E BEQIR HAÇIT, QË FITOI ÇMIMIN E PARË DREJTUAR AMERIKANË TË KRYQIT TË KUQ



Të Rinjve të vërtetë. Kur të largohen nga kjo shkollë, ata do të jenë të përgatitur t'i shërbejnë vendit të tyre si mësues dhe udhëheqës mendimi. Tetë prej tyre janë paraqitur në këtë faqe. Pas tyre do të shihni flamujt e Shteteve të Bashkuara dhe të Shqipërisë duke u valëvitur së bashku.

Në mbyllje të semestrit të parë, djemtë shkruan ese rreth shkollës. Për këto ese u ndanë pesë çmime, të cilat janë në formën e letrave drejtuar Të Rinjve amerikanë. Beqir Haçi quhet djali që fitoi çmimin e parë dhe letra e tij dëshmon për vlerën e madhe të

këtij lloji të punës së Të Rinjve.

“Të dashur të Rinj”, shkruan Beqiri në anglisht, “unë jam një djalë shqiptar katërmëdhjetë vjeç. Shqipëria, siç mund ta dini, është një shtet i vogël i vendodhur në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik. Populli i këtij shteti, megjithëse pak i njohur, vjen nga një racë shumë e vjetër. Shumë shkrimtarë të mëdhenj thonë se ky popull është më i vjetri në Gadishullin Ballkanik. Arsyeja pse Shqipëria është kaq e prapambetur është se fqinjët e saj nuk e kanë lënë kurrë të qetë, por gjithmonë janë përpjekur ta zotërojnë atë. Me shumë thirrje drejtuar

shteteve më të mëdha të Evropës, me luftëra dhe me revolucione, Shqipëria fitoi pavarësinë e saj. Duke qenë e shkatërruar dhe e zotëruar nga të huajt për shumë vite, ajo u bë e varfër. Ajo i thirri të gjithë botës për ndihmë, por askush nuk tregoi mëshirë përveç fëmijëve të kujdesshëm përtej Atlantikut.”

I gjithë populli shqiptar, burra dhe gra, djem dhe vajza, janë shumë mirënjohës ndaj jush, Junior-ë — Nxënës të mirë. Për mirësinë e madhe që po u tregoni njerëzve të tyre, fushat, pyjet, malet, liqenet dhe lumenjtë e Shqipërisë duket se janë të

lumtur. E gjithë Shqipëria po falënderon Zotin për të mirat që u keni dhënë juve, Të Rinj. Të gjithë e shohin se nga Shkolla Profesionale Shqiptare, e cila mbështetet falë ndihmës tuaj, do të dalin djem me arsim të mirë, të ditur dhe të aftë për të zbuluar dhe zhvilluar pasurinë e vendit, e cila tani është e fshehur. Do të dalin djem që do të qëndrojnë larg gënjeshtërisë dhe vjedhjes, që do të dinë dhe do të bëjnë vetëm të drejtën. * * * E falënderoj Zotin që kam pasur fatin e mirë të vij në këtë shkollë. Mësoj shumë gjëra të mëdha dhe të dobishme. Në nëntë muaj kam mësuar ta përdor anglishten pothuajse aq mirë sa gjuhën time.”

Beqiri përshkruan atë që ka mësuar në matematikë, vizatim mekanik, fizikë dhe gjeografi dhe vazhdon :

“Gjërat më të mira që kam mësuar janë si ta mbaj veten të pastër, si të sillem, si të jem mik me të gjithë dhe si t'i respektoj prindërit dhe mësuesit e mi. Kam mësuar gjithashtu disa nga lojërat tuaja, si bejsbollin dhe basketbollin. * * * Kur erdha këtu peshoja 37 kilogramë. Tani peshoj 44.

Shpresojmë që një ditë të jemi në gjendje t'ju shpërblejmë bujarinë. Me këtë ndihmë, jini të sigurt, fëmijë të dashur, se do të bëhemi një popull i ri, i frymëzuar nga ideat e “Shërbimit dhe Miqësisë”, për pjesën tjetër të botës. E mbyll letrën time duke shpresuar se do të na përgjigjeni shpejt dhe se do të na falni për gabimet tona.

Me dashuri për të gjithë anëtarët e Kryqit të Kuq për të Rinj.”

Pra, kjo është në të vërtetë “Letra e Beqir Haçit për ju” dhe jo e redaktorit ! Dhe Beqiri flet për veten e tij, për gjashtëdhjetë e tre shokët e tij nxënës, për të gjithë shqiptarët dhe për të gjithë kauzën e Kryqit të Kuq për të Rinj.

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946





**Akoma
nuk keni
një
WEBSITE?**

**Akoma nuk jeni regjistruar
në Google?**

Web Design

Logo

Business Cards

Banners

**NA
KONTAKTONI**

Tel: 020 7018 7929
Mob:073 4066 5946
Mob:078 5997 7545

Adresa e zyrave:
30 Avenons Road
London
E13 8HT

ARTAN HOXHA

Ndërsa çdo ditë dalin fakte e prova për manipulime të shumëllojshme, të drejtpërdrejta a të tërthorta, mbi kutitë vendase apo mbi votat nga emigracioni, rezultati me diferencë të thellë mes subjektit monist PS dhe koalicionit pluralist PD, prej afro 20% nga afro 2% në vitin 2021, ka vetëm dy shpjegime: i) ose PD ka gabuar plotësisht në përcaktimin e natyrës së regjimit – si regjim antidemokrat, narko-shtet, neo-diktaturë – për rrjedhojë, shumica e votuesve nuk e ndoqi në këtë përcaktim; ii) ose regjimi është vërtetë i këtitillë dhe ka fituar me mjetet e shumta dhe fuqinë e dhunshme të një regjimi të këtitillë. Përgjigja mbi natyrën e regjimit përcakton edhe mënyrën e shpjegimit të rezultatit të votave 2025.

Kam qenë e jam i mendimit, gjithnjë e më të përforcuar, se kemi të bëjmë me një regjim hibrid i cili, në ecurinë e tij këto 12 vite, e kaloi vijën imagjinare 50:50 fill pas zgjedhjeve 2021 duke anuar sot fort e dukshëm, në anën jo-demokratike drejt asaj diktatoriale të spektrit (gatuar edhe për shkak të sjelljes politike të PD në zgjedhjet 2017 dhe pas tyre), ndihmuar qoftë nga faktorë të brendshëm qoftë të jashtëm, siç ai i administratës Biden dhe i Europës politike neo-liberale

. Që në pikënisjen e vet më 2013 e në vijim ky regjim u mbështet edhe nga pjesa dërrmuese e kimit të organizuar, në rritje e fuqizim, si dhe nga pjesa dërrmuese e elitës vendase, të kooptuar e të korruptuar. Natyrisht që regjimi nuk llogaritet nga niveli zero, ai e gëzon vijueshëm mbështetjen his-

toriko-inerciale të lidhur me PPSH/PS, prej më shume se 30% të elektoratit, ndërsa faktorët e tjerë nën analizë i mbivendosen kësaj mbështetjeje për të arritur shumicën komode qeverisëse moniste – i gjithë pushteti në një dorë.

Nën qeverisjen e këtij regjimi Shqipëria mbeti ose ra rishtazi në fundin e tabelës së klasifikimit evropian lidhur me të ardhurat, pagat, pensionet, ndihmën sociale, si dhe mbeti apo u ngrit rishtazi në krye të këtij klasifikimi lidhur me pabarazinë, varferinë, padrejtësinë, prapambetjen. Edhe sipas të dhënës më të fundit të Eurostat, 42% e shqiptarëve përjetojnë disa forma përrjashtimi që i klasifikojnë si të varfër apo në rrezik varfërie, kur ky tregues për vendet e Ballkanit Perëndimor lëviz në intervalin 30-34%, për Rumaninë është 32% (treguesi më i lartë në BE) ndërsa mesatarja e BE është as 22%.

Varfëria shumëdimensionale dhe pasiguria e lartë janë forca shtytëse për emigracion. Por, ndërsa forcat tërheqëse emigratore, të tilla si ulja e barrierave hyrëse në tregun evropian apo amerikan të punës për shkak të kërkesës së lartë për fuqi punëtore, veprojnë simetrikisht lidhur me përkatësinë apo preferencën politike të emigrantëve tanë, forcat shtytëse të brendshme veprojnë asimetrikisht, pra më shumë e më fort mbi ata që janë të lidhur, në një masë e tjetër, me opozitën. Kjo shkakton emigra-

cion asimetrik duke pakësuar bazën elektorale të opozitës demokrate. Kjo asimetri duket është forcuar këto katër vite, si rrjedhojë e humbjes së shpresës në elektoratin opozitar, vite gjatë të cilave opozita politike ka qenë nën goditjet e forta, si kurrë më parë, edhe të të gjithë shtetit edhe të ndërkombëtarëve, kryesisht amerikanëve neo-liberale.

E dhëna më e fundit demografike, lindjet në tremujorin e parë 2025, me rënie vjetore mbi 14% në raport me tremujorin e parë 2024 (për më tepër lindjet ndjeshëm më pak se vdekjet) është shumë domethënëse. Rënia sistematike e lindjeve në dekadën rilindase krahasimisht dekadës së mëparshme, por edhe luhshmëria e lartë e 'kapricioze' e këtij treguesi vit pas viti është prova më e mirë se edhe emigracioni (në formë valësh) ka qenë shumë më i lartë krahasimisht me atë që u rrek të na bindte INSTAT me Censin 2023 edhe se ai ka vijuar edhe në 2024 e vijon edhe sot.

Për rrjedhojë, pjesa dërrmuese e 200 mijë votave më pak në kutitë vendase është shkaktuar nga kjo 'arrati' emigratore edhe këto katër vitet e fundit ndërsa pabarazia në mirëqënie/varfëri për shkak të pozicionit politik provon se shumica dërrmuese e këtyre votave të munguara janë nga votuesit opozitarë 2021 të emigruar këto katër vitet e fundit.

Që krimi i organizuar ka mbështetur regjimin edhe në këto zgjedhje kjo

tashmë duket ashqare. Për më tepër, regjimi i fuqizuar së fundmi, krimin e organizuar e ka tashmë më shumë shërbëtor se partner e, interesante, këtë radhë ju caktoi edhe disa personazhe për të cilët duhet të mblidhnin vota e mbi këtë numër votash do matej asfale performanca e kandidatit anonim por performanca e bandës mbështetëse përkatëse.

Elita vendase - administrative, ekonomike, akademike, profesionale, artistike, sportive - , qoftë pjesa e adultëve të dekadës së fundit të socializmit (e kohës kur zvodhi ideologjia dhe lulëzoi vesi), qoftë ajo lindur e rritur në post-socializëm është formësuar ekonomikisht e kulturisht në këtë mjedis të ashpër me evazion të gjërë, korrupsion të gjithëpërhapur dhe dhunë të fortë, dhunë kjo sa e individit ndaj individit, sa e individit ndaj shtetit dhe sa e shtetit ndaj individit. E formësuar në këto rrethana kjo elitë nuk ka moralin dhe motivin e duhur për të udhëhequr popullin drejt regjimit me më shumë demokraci, ligj, drejtësi e barazi ndaj, në shumicën e saj, kooptohet dhe korruptohet lehtësisht nga ky regjim anti-demokratik duke u vënë, me hir a pahir, në shërbim të tij.

Në kushtet e regjimit që varfëron dhe/ose diskriminon, arratia emigratore duket mënyra më e mirë për t'i shpëtuar edhe varfërisë edhe robërisë së këtij regjimi. Kush mbetet këtu i duhet të zgjedhë robërinë e shpërblyer ose kryeneqësinë me pasoja - afër-

mendësh që shumica zgjedhin të parën.

Sa për emigrantët që votuan, në atë pak përqindje që morën pjesë (me pak se 200 mijë nga 1.7 milion gjithsej me të drejtë vote), rezultojnë të jenë pjesa më militante e emigracionit votues në tërësi, aq më shumë nëse konsiderojmë edhe fuqinë mobilizuese më të madhe të regjimit për militantët e vet edhe fuqinë e tij shpërblyese apo kërcënuese, të atyre drejtpërdrejt apo të familjarëve këtu, edhe mundësinë manipuluese të regjimit, për rrjedhojë vota e tyre jo vetëm nuk mundte e nuk solli ndryshim, përkundrazi do i shërbente siç i shërbeu regjimit antidemokratik.

Ndaj, kush rreket të japë rekomandime se ç'duhet të bëjë PD-ja lodhet kot, askush që beson se kemi të bëjmë me një regjim antidemokratik nuk ka as arsye as nge të dëgjojë ata që thonë se PD humbi zgjedhjet për fajet e veta ndonëse garoi në kushte mjaftueshmërisht demokracie, barazie e ndershmërie.

Arsye e nge ka vetëm për ata që e vlerësojnë regjim si anti-demokratik e nuk pajtohen me të. Për një gjë duhet të jemi të qartë mes nesh, tani e në vijim - përballja me regjimin në konsolidim do jetë gjithnjë e më e vështirë, rrëzimi i tij gjithnjë e më i komplikuar, gjithsesi jo i pamundur ne kushtet e një PD-je që ruajti përmasat e partisë së madhe opozitare (nuk u copëzua në 7-8 pjesë) dhe me një raport të ri, miqësor e bashkëpunues, me administratën amerikane Trump dhe partitë e qendrës së djathtë europiane.

KUVENDI I JUNIKUT – MODEL PËR FORMËSIMIN E VIZIONIT POLITIK TË SHQIPTARËVE NË SHEKULLIN XXI

SKENDER ASANI

Kuvendi i Junikut mbetet jo vetëm një pikë referimi historike, por një model për bashkimin e vizioneve në funksion të një projekti të madh kombëtar. Shekulli XXI kërkon një rilindje të re të mendimit dhe veprimit strategjik shqiptar. Është koha për të ndërtuar një epokë të re të bashkimit, përparimit dhe vetëdijes kombëtare – në frymën e Junikut, por me mjetet dhe sfidat e së sotmes.

Në historinë e kombeve, momentet kur ndërgjegjja kolektive ngrihet mbi ndasitë e përditshme dhe projekton një të ardhme të përbashkët, mbeten gurë kilometrikë të rrugëtimit kombëtar. Një nga këto momente për shqiptarët ishte padyshim Kuvendi i Junikut, i mbajtur më 21–25 maj 1912, që përfaqësonte një akt të thellë vetëdijeje politike dhe kombëtare në prag të shpërbërjes së Perandorisë Osmane.

Në atë moment kritik të historisë, kur harta e rajonit po ridizajnohej dhe popujt përreth artikulonin projektet e

tyre shtetformuese, shqiptarët përmes Kuvendit të Junikut shfaqën me qartësi synimet e tyre politike: mëvetësinë, vetëvendosjen dhe ruajtjen e integritetit të hapësirës shqiptare.

Të udhëhequr nga figura si Hasan Prishtina, delegatët e atij kuvendi ndërtuan një arkitekturë politike me vizion afatgjatë, për të shmangur fragmentimin dhe për të garantuar përfshirjen e të gjitha trojeve shqiptare në projektin e përbashkët kombëtar.

Sot, pas më shumë se një shekulli, ndodhemi para një faze tjetër të rëndësishme historike: përmbjlljes së disa proceseve të mëdha politike dhe përcaktimit euro-atlantik të hapësirës shqiptare. Në një botë ku konstelacionet gjeopolitike po ndryshojnë me shpejtësi, shqiptarët, për t'u përballur me sfidat e reja, kanë nevojë për të njëjtin mobilizim që karakterizoi Junikun e vitit 1912.

Zgjidhja përfundimtare për çështjen e Kosovës kërkon një qasje të mençur dhe gjithëpërfshirëse. Kjo nënkupton ndërtimin e një lidhjeje institucionale të fuqishme me Shqipërinë, si një formë funksionale e afrimit të mëte-

jshëm kombëtar, por edhe pranimin e kërkesave të miqve perëndimorë për të përmbjllur njohjen e plotë të shtetësisë së saj. Këta janë hapa strategjikë në drejtim të konsolidimit të pozitës së Kosovës në skenën ndërkombëtare dhe të rumbullakimit të pavarësisë së saj.

Njëkohësisht, është e domosdoshme që me urtësi politike të rumbullakohet edhe procesi i shtetformësisë së shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, nëpërmjet rritjes së barazisë institucionale, afirmimit të përfaqësimit të drejtë dhe ndërtimit të partneritetit real me faktorin shtetëror. Ky proces duhet të udhëhiqet nga një mendësi moderne politike dhe nga një narrativ i ri që tejkalon provincializmat dhe ndarjet artificiale.

Në këtë kuadër, nuk mund të lihet pa u theksuar pozita strategjike që ka Shqipëria në rajon. Duke ecur me hapa të fuqishëm drejt integritetit evropian, ajo po shndërrohet në një faktor politik dhe ekonomik të rëndësishëm, si dhe në një shtyllë kyçe të stabilitetit në Ballkanin Perëndimor. Ky zhvillim e rrit rolin e Shqipërisë si

urë lidhëse dhe si mbështetje e fuqishme për çështjet shqiptare në të gjitha hapësirat.

Një dimension i rëndësishëm i këtij mobilizimi është edhe mërgata shqiptare në botë. Kontributi i saj ndër shekuj ka qenë thelbësor për mbijetesën dhe afirmimin e shqiptarëve në Ballkan. Sot, në rrethana të reja, ajo duhet të jetë më e organizuar dhe më e angazhuar për vendlindjen – përmes investimeve ekonomike, mbështetjes së zhvillimit institucional dhe lobimit aktiv në mbrojtje të interesave kombëtare në qendrat ndërkombëtare të vendimarrjes. Mërgata mund të shërbejë si një urë e fuqishme mes atdheut dhe botës perëndimore, duke ndihmuar në avancimin e qëllimeve të përbashkëta. Kuvendi i Junikut nuk ishte një akt i izoluar.

Ai ishte produkt i ndërgjegjësimit kombëtar dhe i ndjeshmërisë historike që kuptoi nevojën për unitet. Edhe sot, përballë sfidave të globalizimit, të fragmentimit të brendshëm politik dhe të përplasjes së interesave gjeopolitike, modeli i Junikut mbetet një udhërrëfyes për bashkërendimin e

vizioneve dhe për ndërtimin e një platforme të përbashkët kombëtare.

Kuvendi i Junikut mbetet jo vetëm një pikë referimi historike, por një model për bashkimin e vizioneve në funksion të një projekti të madh kombëtar. Shekulli XXI kërkon një rilindje të re të mendimit dhe veprimit strategjik shqiptar, ku bashkëpunimi institucional ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, afirmimi i barazisë në Maqedoninë e Veriut, integrimi i përsheptuar i Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe roli i fuqizuar i mërgatës shqiptare përbëjnë shtyllat e qëndrueshme të së ardhmes sonë.

Vetëm përmes një mobilizimi të tillë gjithëkombëtar, me një mendësi të qartë euroatlantike dhe me një diplomaci të mençur, shqiptarët mund të sigurojnë vendin që u takon në hartën e re të rendit botëror dhe të kontribuojnë në paqen dhe zhvillimin afatgjatë të rajonit.

Kjo është koha për të ndërtuar një epokë të re të bashkimit, përparimit dhe vetëdijes kombëtare – në frymën e Junikut, por me mjetet dhe sfidat e së sotmes.



RESTORANT PER SHITJE

Shitet nje restorant
I rinovuar, në një nga
zonat më të frekuentuara
të Londrës, në Romford
I hapur prej vitesh
me klientele te garantuar
Ambient fantastik per
festa, ditelindje,
fejesa martesë etj
Çmimi shumë i
arsyeshëm
Për më shumë info tel:


FOR SALE



07377 322424



AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?



AKOMA NUK JENI REGJISTRUAR NË GOOGLE?



Search Engine
Marketing



Online
Advertising



Social Media
Marketing

PËR ÇDO KONSULTIM
MUND TË VINI
NGA ZYRAT TONA



020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545



ADRESA E ZYRAVE
30 Avenons Road
London E13 8HT

VETON SURROI

Kosova mund ta ngushëllojë veten se është duke kërkuar një qendër të re politike që do ta udhëheqë vendin që është tashmë sfidë e madhe për demokracitë tradicionale të Evropës. Por, kërkimi i qendrës në Evropë është fillimi i një procesi të ri historik, e Kosova nuk mund të hyjë në të si spektatore pa qeveri me forcë legjitimiteti të shumicës së qytetarëve të vet.

1.

Ka shumë mënyra për ta analizuar krizën e tanishme politike në Kosovë lidhur me formimin e institucioneve qeverisëse pas zgjedhjeve që janë mbajtur tashmë para më shumë se tre muajsh. Njëra formë është ajo që tradicionalisht merret me personalitete, inate e teori të konspiracionit-pse ky lider sillet kështu, kush kë e ofendoi më shumë dhe kur e bëri këtë dhe çfarë sekreti fshihet prapa sjelljes së kësaj apo asaj partie?

Ka gjithsesi ushqim të mjaftueshëm për kësi lloj interpretimi. Po: ka inate, ka edhe ofendime, ka edhe duar të fshehura konspirative të interesave komerciale e të tjera që përfshihen në politikëbërje.

Dhe s'do mend se kjo ndodh në Kosovë e në çdo vend tjetër të botës: kur në Kosovë flitet për ndikimin e oligarkive në politikë apo për politikën që po përpiqet të kufizojë interesat e biznesit apo edhe të medieve (që akuzohen se janë të kontrolluara prej oligarkive) një ligjërim i këtillë ka mundur të kopjohet drejtpërsëdrejti prej demokracisë amerikane dhe akuzave e kundërakuzave të ngjashme. Ka mundur të kopjohet edhe prej ligjëritimit të demokracive italiane, gjeorgjiane apo indiane. Politika nuk ka imunitet prej shoqërisë, është pjesë e saj.

Por, ekziston edhe një interpretim tjetër që ia vlen të shtjellohet, e ai është përpjekja për gjetjen e një qendre politike. Me një këso qasje, ditët që po përjetohen në Kosovë janë krizë për gjetjen e një qendre politike që do të jetë mjaftueshëm e fortë për ta shpënë vendin përpara, posaçërisht në epokën e pasigurisë që po e pëson bota që nga lufta ruse kundër Ukrainës dhe të fundit të Paqes amerikane.

Në këso interpretimi partitë politike, me shpërndarjen e votave ashtu si menduan votuesit e Kosovës pas revolucionit zgjedhor të para katër vjetëve me të cilin i dhanë mandat revolucionar një force politike, tash po e çajnë hallin se si të ndërtojnë një qendër të re politike në situatën ku nuk ekziston një mandat revolucionar.

2.

Nëse është kështu- me gjithë veçantitë e diskriminimit pozitiv të komu-

DUKE KËRKUAR QENDRËN: KRIZA E HESHTUR KOSOVARE (DHE EVROPIANE)



niteteve joshumicë me vendet e ndara në Kuvend - atëbotë Kosova nuk dalon shumë prej vendeve të tjera evropiane. Belgjika, Holanda e Austria - vende me traditë të rrënjësor demokratike - brenda dy vjetëve të fundit shpenzuan muaj të tërë për të ndërtuar një pushtet të qendrës.

Kjo është kostoja e një procesi këmbëngulës dhe frytdhënës evropian të pasluftës së Dytë Botërore, pjesë e Paqes amerikane.

Në të, pak me mjete publike e pak edhe me veprime të fshehta u ndërtua një traditë politike me të cilën u bë përpjekja që votuesit të largohet nga skajshmëritë e fashizmit dhe komunizmit e të kalojë sa më afër qendrës. Kështu u lind tradita kristian-demokrate e qendrës së djathtë dhe u forcua ajo socialdemokrate e qendrës së majtë. Dhe, që të gjitha lëvizjet e ndryshme u ftuan që të marrin pjesë në këtë ndarje, me nuancat e ndryshme të së djathtës e të majtës në mënyrë që pas zgjedhjeve të krijojnë qendrën.

Dhe, kjo traditë mund të quhet e gjallë me bisedat për koalicionet e me koalicionet e votuara, si ai dje në Gjermani, e nëse i shërben si ndonjë ngushëllim Kosovës, qytetarët e saj mund të arsyetohen se partitë e tyre po bëjnë saktësisht atë që bëjnë evropianët tradicionalisht, të kërkuarit e qendrës politike që do të jetë stabiliteti i pushtetit për periudhën e

ardhshme.

3.

Problemi i këtij ngushëllimi është se qendra politike në botën perëndimore ka ndryshuar dhe po ndryshon për aq sa ajo më nuk ekziston siç u mësua tradicionalisht.

Në dhjetor të vitit të kaluar në Washington një mik republikan që ishte tradicional e që tash bën pjesë në kampin e presidentit Trump pranoi vërejtjen time se ardhja e presidentit Trump në mandatin e tij të dytë ishte konfirmim se në Amerikë më nuk ekziston e djathta tradicionale e rrjedhimisht as e majta demokrate nuk mund të qëndrojnë në formën e vet tradicionale. Presidenti është duke riinterpretuar jo vetëm spektrin politik por edhe natyrën e demokracisë amerikane.

Shumë më herët një fenomen i këtillë kishte ndodhur në Itali ku nga skena politike ishin zhdukur kristian-demokratët dhe socialistët, e djathta dhe e majta tradicionale.

Në vend të tyre, qendra e sotme politike italiane përfaqësohet nga një forcë politike që deri dje konsiderohej si e djathtë e skajshme, e quajtur "neofashiste" madje, e prirë nga kryeministria Meloni.

Modeli italian u replikua në një masë në Francë me zbehjen e forcave politike tradicionale dhe sot lufta për qen-

drën politike nuk është mes të majtës e djathtës, por mes presidentit centrist Macron dhe të djathtës së skajshme me Marie Le Pen; një president pa shumicë, një parlament pa qartësi, një republikë që e ndien se po i skadon energjia politike.

Dhe qendra gjermane, përkundër forcës së koalicionit të partive tradicionale CDU/CSU me SPD, është nën presion të madh nga forca e cila është tashmë e parë politike, AfD e ekstremit të djathtë, e shpallur si rrezik për sigurinë kombëtare nga shërbimi sekret gjerman BND.

Ky është tashmë realitet edhe në periferinë evropiane, siç u dëshmuua me votën presidenciale rumune, ku votuesit po tregojnë se do të hedhin jashtë lojë partitë tradicionale të vetëquajtura të majta e të djathta. Votuesi rumun gjithnjë e më shumë parapëlqen mesazhin nacionalist, të zhveshur prej nocioneve ideologjike tradicionale të së majtës e të djathtës, dhe të zhveshur po ashtu prej nocioneve të përgjegjësisë e solidaritetit evropian.

MAGA - lëvizja amerikane e Trumpit, po klonohet në Hungari, Rumani e Sllovakia, vende të NATO-s që tash po kërcënohen të shndërrohen në vende me antipati të dukshme për çdo gjë që u konsiderua "modë" liberale (përkrahje e refugjatëve, të drejtave homoseksuale, etj.) dhe me simpati për Rusinë e Putinit.

Ky është përcaktimi i ri i nocionit "Qendër politike" në një pjesë të konsiderueshme të Evropës.

4.

Ngushëllimi kosovar mund të jetë që përpjekja për të gjetur qendrën politike nuk është shumë e ngjashme me atë të pjesës tjetër të Evropës, së paku jo asaj tradicionale. Pra, jo, problemi nuk është ideologjik i ndonjë konfrontimi mes të majtës tradicionale dhe të djathtës tradicionale - për faktin e thjeshtë se në Kosovë ende nuk ka të majtë e të djathtë tradicionale. Ende nuk ka përvojë të mjaftueshme që do të meritonte emrin traditë.

Por, ky nuk është ndonjë ngushëllim i qëndrueshëm.

Evropa e qendrës tradicionale pothuajse nuk ekziston më dhe kemi hyrë në epokën ku po përcaktohet se çka do të jetë qendra. Dhe, kjo është një epokë pasigurie në të cilën po ndërtohet një konstatim logjik: Evropa ka hyrë në procesin e kërkimit të qendrës së vet të re dhe ky do të jetë proces i gjatë historik që ka filluar tani por Kosova nuk e ka luksin që ta vëzhgojë këtë proces pasigurie duke mos e pasur qendrën e vet të konsoliduar. Vendimin për këtë - me koalicion të ri tash a pas zgjedhjeve të reja imediate -partitë dhe votuesit e tyre duhet ta marrin shpejt.

AKOMA NUK KENI WEBSITE?

AKOMA NUK JENI REGJISTRUAR
NË GOOGLE?

Dotech
website 

**Ne mund t'iu
ndihmojme me:**

- Business Cards
- Logos
- Posters
- Banners
- Video Marketing

**Për çdo konsultim
mund te vini nga
zyrat tona**



**ADRESA E ZYRAVE:
30 AVENONS ROAD
LONDON E13 8HT**

**Tel: 020 7018 7929
Mob: 073 4066 5946
Mob: 078 5997 7545**

REL

REL: A KA SHANSE TË RINISË DIALOGU KOSOVË-SERBI NË RRETHANAT AKTUALE?

Shefja e diplomacisë e Bashkimit Evropian porositi këtë javë se “tani është koha për riangazhim” nga Kosova dhe Serbia në dialogun e ndërmjetësuar nga Brukseli për normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve.

Porosia e Kaja Kallasit, me paralajmërimin se dialogu është domosdoshmëri që ato të ecin drejt integritimit evropian, u dha në prag të vizitës së saj në kryeqytetet e dy vendeve, të mërkurën dhe të enjten.

Më vonë, në Beograd, ajo tha se planifikon të ftojë në Bruksel “sa më parë të jetë e mundur” përfaqësues nga të dy vendet “për të diskutuar hapat përpara” – pa përmendur se kush do të marrë ftesë saktësisht.

Por, njohësit e zhvillimeve politike në Prishtinë dhe në Beograd janë pesimistë nëse rikthimi në dialogun e nivelit politik ndërmjet dy vendeve është i mundshëm tash për tash.

Pas zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit, Kosova ende nuk ka arritur të përmbyllë konstituimin e Kuvendit, që do t'i hapte rrugë procesit të krijimit të qeverisë së re.

Ndërkaq, Serbia, në muajt e fundit është duke u përballur me protesta të shumta dhe turbullira politike.

Legjitimiteti i palëve biseduese

Afrim Hoti, profesor i së Drejtës dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin e Prishtinës, thotë për Radion Evropa e Lirë se dialogu nuk ka kuptim, nëse ai nuk udhëhiqet nga liderë që kanë kredenciale dhe legjitimitet në vendet përkatëse.

Problematika kryesore, sipas tij, ndërlidhet me faktin se Kosova drejtohet nga një qeveri në detyrë.

Në përputhje me Kushtetutën e Kosovës, dialogu me Serbinë udhëhiqet vetëm nga qeveria e vendit. Ndërkaq, në këtë proces, palën e Serbisë e drejton presidenti i saj.

“Unë nuk besoj që do të kemi rund apo përpjekje për një takim eventual, të paktën jo për aq kohë sa nuk themelohet qeveria e re në Kosovë”, thekson Hoti.

Në anën tjetër, pas një incidenti në Novi Sad, më 1 nëntor të vitit të kaluar, që i mori jetën 16 personave, autoritetet në Serbi u ballafaquan me protesta për disa muaj.

Qeveria e atjeshme, e drejtuar nga Millosh Vuçeviq, dha dorëheqje dhe u zëvendësua nga një kabinet qeverisës që aktualisht drejtohet nga Gjuro Macut, i cili, sikurse paraardhësi, është pjesë e Partisë Progresiste Serbe, e themeluar nga presidenti aktual i Serbisë, Aleksandar Vuçiq.



Dushan Janjiq, nga Forumi i Beogradit për Marrëdhënie Etnike, thotë për Radion Evropa e Lirë se zhvillimet e muajve të fundit në Serbi e kanë luhatur seriozisht pushtetin e Vuçiqit.

“Në Serbi nuk ka qeveri legjitime, por vetëm legale”, shprehet Janjiq, duke shtuar se insistimi i përfaqësueses së Lartë të BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Kallas, për rinisje të dialogut tani, duket si qasje burokratike, me sloganin “duhet të nisë”.

“Mirë që ka ardhur [Kallas, në Beograd dhe në Prishtinë], që të shohë se negociuesit me të cilët bisedon janë ‘rrëfim bosh’, dhe të nisë ta përgatisë aparatit e saj dhe veten për një metodologji të negociatave. Në rast të kundërt, do ta humbë mandatin e lehtësueses [së dialogut]”, vlerëson Janjiq.

Faza e ardhshme e procesit

Të mërkurën, Vuçiq tha se “Serbia

është e vendosur për dialog konstruktiv me ndërmjetësimin e BE-së”.

Por, ai shtoi se ia ka përkujtuar kryediplomates Kallas se formimi i Asociacionit të komunave me shumicë serbe nga pala kosovare është “një parakusht për përparim të mëtejshëm në dialog”.

Gatishmërinë e Kosovës për të marrë pjesë në procesin e dialogut e ka shprehur edhe presidentja Vjosa Osmani, por ajo i ka bërë thirrje BE-së që, paraprakisht, “duhet të flasim për heqjen e masave nga ana e BE-së, sepse kjo e dëmton edhe vetë kredibilitetin e BE-së”.

BE-ja vendosi masa ndëshkuese ndaj Kosovës më 2023 – pas rritjes së tensioneve në veri të vendit. Masat e tilla vazhdojnë të jenë në fuqi.

Në prill, Kallas bëri me dije se BE-ja është duke i zbrëthyer gabimet në dialogun e Brukselit mes Kosovës dhe Serbisë, në mënyrë që t'i japë gjallëri

procesit.

Duke iu referuar kësaj deklaratë, Hoti shpreh mendimin se nuk ka shumë tema për të cilat mund të bisedohet, kurdo që të rinisë dialogu në Bruksel.

Sipas tij, problem mbetet zbatimi i marrëveshjeve të arritura ndërmjet dy vendeve, duke përfshirë atë kryesoren, Marrëveshjen për rrugën drejt normalizimit të raporteve, e njohur si Marrëveshja e Ohrit.

“Fundja, nëse ne kemi në sfond një listë të marrëveshjeve, për të cilat është dhënë pajtimi nga udhëheqjet përkatëse, dhe nuk kemi zbatimin e tyre praktik, vazhdimi i procesit negociues del i panevojshëm, i palogjikshëm, nuk ka racionalitet”, thotë Hoti.

Ai pret që strategjia e re e Kallasit në fazën e ardhshme të dialogut të jetë zbatimi i marrëveshjeve të deritashme, duke ushtruar presion të balancuar tek të dyja palët.

Edhe Janjiq shpreson që vazhdimi eventual i procesit, kurdo që të ndodhë gjatë mandatit të Kallasit, të mos jetë përsëritje e qasjes së “menaxhimit të konfliktit”, siç ishte, sipas tij, gjatë mandatit të pararendësit të saj, Josep Borrell.

“Shpresoj që ata [BE-ja] do të mendojnë seriozisht dhe do të nisen rrugën që do ta ndjekin amerikanët. Kjo nënkupton: tavolina të rumbullakëta, procese të shkurtuara të bisedimeve dhe, më e rëndësishmja, të hapin ‘Zyrën për zbatim’”, shprehet Janjiq.

“Zyra për zbatim”, sipas tij, do të mbikëqyrte zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të arritura deri më tash në procesin e dialogut, dhe do t'i raportonte BE-së për rezultatet.

Megjithatë, ai nuk pret që procesi të rinisë deri në fund të këtij viti, pa arritjen e stabilizimit të rrethanave dhe skenave politike në Kosovë dhe në Serbi./ REL

**190 Merton high street
Wimbledon
London SW19 1AX**



RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths



Ne mund t'ju ndihmojmë

- **Asylum & Immigration**
- **New Point Based System**
- **Settlement Applications (ILR)**
- **European Law**
- **Nationality & Travel Document**
- **Human Rights Applications**
- **High/Court of Appeals**
- **Over Stayers**
- **Work Premits**
- **Visa Extensions**
- **Judicial Reviews**
- **Tribunal Appeals**



Konsultimet falas

07774222062

07878335000



OPENING SOON